

# DUEL ME FLAKËN

JORDAN HAXHINIKOLLA



854-32-4

S

H 32 JORDAN HAXHINIKOLLA

# DUEL ME FLAKËN

Tregime dhe skica

4634) —  
QALIOTEKA E SHILIDE  
SHIROKASIFER

NMT

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

## DUEL ME FLAKËN

Ishët akoma natë dhe yjet vezullonin në qiellosi si qirinj të ndezur, kur arrita në bateri. Në një cep të hapësirës vura re Kashtën e Kumtrit që ndriste si një rrugë e bardhë. Nata binte erë të thatë dhe plot kundërmime të papercaktuara. Kohë vjeshte. Bateria që rreshtuar. Luftëtarët me helmete në kokë qëndronin pranë njeri-tjetrit me pushkët të hedhura krahëqafë.

«Çdo gjë në rregull» mendova.

Pas pak erdhi një maqinë në drejtim të baterisë. Dritat aty dukeshin dhe aty zhdukeshin. Kush të ishte vallë? Gazi qëndroi disa hapa larg. Dikush zbriti. E njoha: ishte shoku Lym Keta, eprori ynë. U drejtova tek ai dhe i paraqita forcën.

— Si i keni punët?

— Jemi gati.

— Dolën të gjithë?

— Dolën, shoku komandant.

— Njerëzit janë mirë?

— Si urdhëroni.

Qëndronte më këmbë pranë meje, me kapotën e gjatë deri në gju. Fytyra e tij e bukur dhe bu-

rrerore të bënte për vete. Për të pata dëgjuar se kish qenë trim i madh në luftën partizane, dhe kish luftuar atje ku aksioni qe më i vështirë e më i rrezikshëm.

— Kontrolluam tërheqësit, artilerinë, njerëzit.

— Teknikën e kemi të mirë, por njerëzit edhe më të mirë. — Pastaj shtoi. — Ushtari është kryesorja.

Qëndroi pranë tërheqësit të parë. Ushtarët u quan në këmbë.

— Rrini, rrini. Si jeni, o burra?

— Shumë mirë jemi, shoku komandant — thanjë ushtar nga Peshkopia. Ata e njohën dhe u gjallëruan kur e panë midis tyre.

— Si thoni ju, a do të dalim mirë?

Përsëri foli ushtari.

— Do të dalim mirë, se s'bën.

— Ç'detyrë ke?

— Vrojtues.

— Të lumtë.

Ushtarët qeshën. Qeshëm edhe në, pastaj u larguam.

Dhashë komandën për marshim. Tërheqësit u vunë në lëvizje. Toka dridhej nën këmbët tonë. Shikoja sytë e mëdhenj, të thellë e të menduar të eprorit, hundën e drejtë e të bukur, i vështroja kapotën, çizmet e gjata që i rrinë të puthitura pas këmbëve. I téri dukej si një bust prej bronxi i vendosur aty përpara baterisë, që shkonte në stërvitje.

Frynte erë e ftohtë. Pemët nëpër oborret e shtëpive lëkundeshin, ndërsa nga oxhaqet dilte një tym ngjyrë hiri që shpërndahet në qiell. Zinxhirët e tërheqësve vërtiteshin duke lëshuar një

kërkëllimë shurdhonjëse. Ndërkohë po gdhinte. Ylli i mëngjezit shkëlqente me një bukur të rraillé. Në një arë po punonte një traktor me drita të ndezura. Aroma e tokës së punuar arrinte deri tek ne. Traktori çante përpara, ndërsa plugjet kthenin dheun e njomur nga vesa e mëngjezit.

Ecën gjithë ditën e ditës. Tërheqësit, duke ngjitur të përpjatat, uturinin. Topat kalonin njeri pas tjetrit. Ushtarët qëndronin nëpër vendet e tyre me xhaketat e pluhurosura. Në mbrëmje u ndalën në të dalë të një fshati. Fëmijët kureshtarë iu afroan tërheqsve dhe topave duke u ardhur përqark. Muzgu përhapi ngadalë napën e zezë mbi luginë dhe mbi fshat. Në qell u dukën re të ngarkuara njyrë plumbi. Pak më vonë filloi shiu.

— Në këto vende kemi luftuar me një kompani partizanesh kundër gjermanëve.

— Kur?

— Më 1943. Asnjë këmbë nazisti nuk u fut në fshat, megjithëse i ndihmonin ballistët.

E pyeta:

— Nga tanët u vra njeri?

— Partizanët luftuan si trima. Një shok e qëlluan atje te lapidari.

Tregonte thjeshtë pa zbukurime, ndërsa përveten e tij nuk foli asnjëherë.

Mbi fshat, tek një kodër, do të vendosej artilleria. Mblodha komandantët e topave dhe u sqa rova detyrën. Topat duhej të shkonin lart në pozicionet, nëpër rrugët më të vështira. Njerëzit filluan nga puna. Që të gjithë punonin, oficerë e ushtarë. Një pjesë rregullonin pikën e vrojtimit, të tjerë bënин pozicionet e zjarrit. Shiu binte vazhdimisht.

Pranë topit të dytë Lym Keta u ndal.

— Ku është përgjegjësi i topit?

— Këtu — u përgjegj nën oficeri, i lyer me baltë dhe i lagur qull.

— Çfarë po bëni?

— Pozicionin.

— Kështu bëhet vallë pozicioni i topit? Kjo s'është gjë tjetër veçse gropë, ku mund të lozin fëmijët.

Nën oficeri u skuq; herë më shikonte mua, herë Lymin, i cili fliste qetë, me ton jo urdhërues. Vetëm sytë e tij tregonin fare mirë se nuk ishte i kënaqur. Kërceu brenda, mori lopatën e një ushtari dhe filloi të tregojë si duhej bërë pozicioni.

— Më thellë, sa më thellë. Kështu do të zbuloheni menjëherë. Një objekt i zbuluar është i asgjësuar.

Më tutje takuam ushtarët nga Peshkopja. Ai po maskonte pikën e vrojtimit në mënyrë të përsosur.

— A ka qenë me lejë? — më pyeti kur u larguan.

— Jo.

— Po të isha në vendin tënd do ta dërgoja. Ka punuar mirë.

U kthyem në çadër me të gdhirë i bërë qull nga shiu dhe i lodhur. Edhe atje dëgjoheshin zhurmat e kazmës që ndeshesh në gur dhe urdhërat e dhëna me zë të lartë.

Gjithë natën e natës ra shi. Nga perëndimi vetëtimat grisnin perden e errët të natës. Ato dukeshin si vija të çrrëgullta dhe, menjëherë pas tyre dëgjoheshin bubullima të forta si krisma e një topi të kalibrit të madh. Toka thëthinte ujët e shiut, ndërsa pluhuri i rrugëve ishte kthyer në baltë, që ngjitej në këpucët e ushtarëve, i lodhte dhe u

lagte këmbët. Por në mëngjez koha u hap përsëri. Retë u larguan të shtyra nga era. Rrezet e zbeta të diellit vjeshtak ranë mbi fshat, mbi kodër dhe mbi baterinë tonë. Një aromë e vakët dhe dehëse na futej në mushkëri me ajrin e pastër. Nga çadra u ngritet avuj të hollë. Hendeqet dhe gropat ishin mbushur me ujë. Nga degët pikonin pika uji.

Në orën gjashtë filloi ngjitja e topave në pozicionet e zjarrit të futura në tokë. Balta ishte bërë llucë. Rrotat e topave fundoseshin në baltë. Këmbët e ushtarëve mezi shqiteshin nga toka.

«Dreqi e mori» shfryva me vete.

Limi nxori kapotën dhe mbështeti duart në rrotat e një topi. Unë vajta te një tjetër. Njerëzit muarën zemër.

— Hoo-hop!

Topat ngjiteshin pak e nga pak mbi sipërfaqen e kodrës, në rrugë e pa rrugë, duke rrëshqitur në baltë, në pellgjet e vogla me ujë. Ushtarët i shtynin. Ata ishin të lagur deri në palcë dhe sytë u skuqnin nga pagjumësia.

Topi i tretë mbeti. Ai nuk lëvizte. Çfarë kish ndodhur? Vajta atje. I thërrita komandantit të topit.

— Shoku komandant i baterisë — përgjigjet ai me zë të lodhur — topi nuk shkon lart, është baltë e madhe...

— Siii?! —

Ai u step.

— Ti nuk mund të ngjitésh lart topin? — e pyeta.

— Terreni është i vështirë...

— Zbatoni urdhërin!

Numërorët qëndronin para topave dhe prisin.

Grykat e zjarrit shkëlqenin nën rrezet e diellit. Më dukej sikur gjithshka kish qëndruar në vend. Isha i shqetësuar. E ndjeja veten si nxënësi përparr provimit. Lymi vështronte grykat e zjarrit dhe buzëqeshte. Ndoshta mendonte se në ato çaste e kisha vështirë.

Mora telefonin dhe thirra:

— Bateria për luftim!

Urdhërin për luftim e përsëriti komandanti i vijës së zjarrit, pastaj me radhë komandantët e topave.

Një çast qetësie e pastaj njerëzit iu afroan topave.

— Mbi këmbësorinë, predhëthërmuese...

— Zjarr!

Krisma qe e fortë, shurdhonjëse. Lugina buçiti. Toka u drodh. Në vendin ku plasi predha një re pluhuri e dendur u ngrit përpjetë. Shenja nuk dukej më. Në çaste të këtilla, ne, artelierët na push-tojnë ndjenja gëzimi që nuk i përbajmë dot. Komandanti i vijës së zjarrit raportonte në telefon:

— Shoku komandant i baterisë: shenja u asgjësua!

Edhe Lymi gëzohej kur artilierët e baterisë gjuanin mirë.

Gjellën e hëngrëm në pikën e vrojtimit e në pozicione. Ushtarët patën ndezur zjarre dhe po thaheshin. Gjella ishte e ngrohtë dhe e shijshme. Një pjesë qenë shtrirë mbi fier, dysheku i ushtarit.

Megjithatë stërvitja s'kish marrë fund. Në report na prisnin një tok me punë: pastrimi i zinxhirëve vënja e topave në gadishmëri. Gadishmë - «uji flë, hasmi s'flë».

Bateria u vu në lëvizje. Do të ktheheshim  
në repart.

Po i afroheshim një ure.

— Kujdes!

Tërheqësi, ku gjendesha unë, u fut mbi urë.

— Prije djathtas!

Leva lëvizi, por maqina nuk bindej.

— Djathtas — i bërtas i zemëruar shoferit.

Barku i tërheqësit zuri në njérën anë të urës.

Gjysma e tij u var në boshllék.

— Ushtarët të zbresin poshtë. Largoni topin!

— Çfarë ka ngjarë? — pyeti Lymi që sapo u  
afraua.

— U blokua leva.

— Municionin e nxorët?

Municioni ishte brenda dhe unë e kisha harruar. «Eh! komandanti i baterisë, ku e ke kokën», thashë me vete. Me zë të fortë urdhërova të nxirrej municioni nga tërheqësi. Ushtarët filluan nga puna.

— Vendosni kavot! — urdhëroi Lymi.

Ai thëriste, vepronte, shtrinte kavot. Të gjithë e ndihmonin. Në atë çast edhe sekondat kishin vlerë. Tërheqësi mund të rrëzohej së bashku me predhat e djegoret dhe atëhere... Duhej shpejtuar për të mënjanuar katastrofën. Por kavot u këputën dhe, menjëherë tërheqësi u rrëzua në përrua.

Poshtë në përrua tërheqësi qëndronte i përblysur me zinxhirët të kthyer drejt qellit, si një kafshë e madhe e plagosur. Motori punonte me të gjitha fuqitë, duke nxjerë nga të dy tubat tym e flakë. Po sikur të merrte zjarr? Ushtarët vështronin në fund të përroit atë maqinë të stërmadhe të cilën e njihnin deri në mekanizmat më të vogla. Ndoshta nga çasti në çast do të dëgjohej një shpër-

thim i tmerrshäm dhe çdo gjë do të merrte fund.

— Municioni u têrroq i téri? — pyeti Lymi.

— Jo, shoku komandant.

— Si?

— Një pjesë mbeti...

— Atëhere largoni ushtarët. Largohuni edhe ju.

— Unë...

— Ky është urdhër. Largohuni!

Dikush më foli nga prapa:

— Shoku komandant i baterisë...

Nënëficeri, komandanti i topit të tretë, më del përpara.

— C'farë doni?!

— Më lejoni të vete poshtë në përrua.

— Është rrezik.

— Ndoshtha mendoni se unë...

— Jo, nuk mendoj...

— Atëhere më lejoni...

E pashë në sy.

— Mbas meje — i thirra.

Që të dy zbritën në përrua.

Pranë têrheqësit që uturinte, komandanti, Lymi, mundohej të hynte në kabinë, për të mbyllur burimin e ushqimit. Ai përpinqej të shuanë motorin. Në fillim u duk sikur motori do të fikej. Por nuk ngjau ashtu. Ai filloi të punonte përsëri duke nxjerrë nga tubi vetëm flakë. Lymi qëndronte në këmbë pak i zbetë, me bulza djerse në ballë. I lodhur, qëndroi pranë një topi dhe po e vështronë. Nuk kaluan veçse disa sekonda kur ai u sul menjëherë në drejtim të kabinës. Motori buçiste. Nga tubi dilte vetëm flakë. një flakë e frikshme, si ajo e flakëhedhëses.

Tani Lymi drejtoi kutinë zjarrfikëse mbi flakë.

Muskujt e fytyrës së tij qenë tendosur. Flaka e kuqe në të verdhë i përcëllonte duart, fytyrën dhe e kanoste. Qëndrote drejt, me këmbët të ngulura në baltën e pérroit, dhe mundohej të dilte fitonjës në atë dyluftim. Por flaka nuk donte t'ja dinte: ajo përhapte në ajër gjuhë të kuqe, të nxeh-ta, përcëllonjëse. Fytyra i ishte mbuluar me djersë, muskujt i qenë tendosur. Kush i jepte atij kaq forcë? Ndoshta bindja, disiplina, kalitja ushtarake? Më në fund flaka u zvogëlua, u tkurr dhe u kthye nëntym. Ajo ishte mundur. Lymi, i qetë, vajti u ul mbi top. Nxori kutinë e cigareve dhe ndezi një. Merrte frymë lirisht sikur të mos kish ndodhur asgjë. Një buzëqeshje e lehtë i endej mbi buzë. Hodhi vështrimin nga unë, një vështrim të ëmbël, pak qortonjës.

- Kush ju dha lejë të vini?
- Unë jam fajtor për këtë që ndodhi.
- Pse nuk zbatuat urdhërin?

Nuk mund t'ju lija vetëm, shoku komandant.

Ula kokën. Qëndroja pranë tij i turpëruar dhe mundohesha të parafytyroja kohën e luftës parti-zane, kur ai futej më strofkën e armiqve dhe u kallte tmerrin.

## KOMANDANTI I KOMPANIË

1

Lymi, komandanti i kompanisë, qe një djal i ri me shtat të gjatë, bile tepër të gjatë për mo-shën e tij të njomë. Flokët kaçurrele e të zez mezi i bindeshin gishtërinjve të tij. Sado që mundohej t'i shtronte me një të shkuar të dorës, ato përsëri mblidheshin dhe merrnin formë. Vetëm kokorja prej leshi që mbante në dimër i detyronte disi të rrinin më të shtruar.

— Shoku komandant — e pyeta ndërsa ai vrojtonte me dylbi në drejtim të pyllit.

— C'është, Meti.

— A duken gjermanët?

Lymi uli dylbitë; pastaj u kthye nga unë.

— Jo, nuk po duken.

— A të shoh edhe unë një herë me dylbi?

— Eja këtu.

Me një të kërcyer u gjenda pranë tij dhe vendosa dylbitë pranë syve. Sa bukur shikoja me to! Të gjitha objektet: pemët, kodrat, rrugët duke-

shin aq afër sa mund t'i zija me dorë. Për herë të parë në jetën time po shikoja me dylbi.

— I sheh gjermanët me ballistët? — më pyeti Lymi.

— Jo.

— Ndoshta janë fshehur mirë.

— S'kanë nga të na ikin, o shoku komandant.

Këto dylbi kishin historinë e tyre. Ato Lymi ja kish marrë një oficeri gjerman në luftën e Arbanës. Më kujtohet si tani. Gjermanët, të ndihmuar nga tradhëtarët e vendit, patën mbyllur në mullirin e fshatit nga pesëdhjetë burra simpatizantë të lëvizjes për t'i pushkatuar. Ne ramë në erë për këtë gjë. Organizuam një sulm, por gjermanët bënnë qëndresë. Armiqtë kishin pozicione të mira. Sulmuam përsëri. Këtë radhë ata nuk i bënë dot ballë sulmit tonë, prandaj u tërhoqën duke u mbyllur në një tjetër mulli. Rrethimi qe i fortë si një darë e hekurt. U thirrëm të dorëzoheshin. Një zë i ashpër gjermani, pak si në të ngjirur, doli nga të çarat e çatisë dhe arriti deri tek ne. Në fillim nuk kuptum gjë. Më vonë një partizan, ish-student i gjimnazit të Tiranës, që merrte pak vesh nga gjuha e tyre, na përktheu kuptimin e atyre fjalëve.

Lymi u vrejt.

— Qenat! S'duan të dorëzohen! Pse, ku janë, këtu, në shtëpi të tyre?

— C'do të bëjmë? — e pyeta komandantin.

— Do t'u japim një mësim që ta mbajnë mend për gjithë jetën.

Pas një ore luftimi të ashpër gjermanët u asgjësuan. Midis tyre qe një oficer, një trupmadh e leshraverdhë, i cili qe shtrirë në shpinë nga dhjetëshja e Lymit. Dylbitë i qëndronin të varura në

gjoks dhe dukeshin sikur thoshin «Po mua nuk do të më merrni?» Kështu pat ndodhur atëhere historia e dylbisë së komandantit. Duke i mbajtur tanipërpara syve, nuk ngopesha së pari natyrën e bukur të viseve të çliruara: kodrat, pyllin me mare dhe tutje, poshtë, rrugës automobilistike. Rrëzë kodrave një karvan me disa kuaj të ngarkuar më tërroqi vëmendjen. Ndala frymëmarrjen. Karvani herë dukej pjesë-pjesë, herë fshihej prapa ferrave të larta.

— Gjermanët — thirra me të shpejtë duke i dhënë dylbitë komandantit.

— Ku?!

— Poshtë kodrës.

Lymi drejtoi vështrimin andej nga tregoja unë.

— Më duket se ata janë!

Partizanët zunë pozicionet, gati për luftë.

— Kur të hap zjarr me Sharsin atëhere do të qëlloni të gjithë — dha urdhër komandanti i kompanisë. — T'i lëmë të afrohen dhe ca e pastaj fillojmë dasmën.

Pritja sjell me vete një ankth që të mundon. Dëgjoja hapat e kuajve që përplaseshin pas gurreve tek afroheshin në drejtimin tonë. Mitrolozi Shars i Lymit shkëlqente nën rrezet e diellit me një shkëlqim që më vriste sytë. Pranë tij rrinte Iloja, furnizuesi, me dy kasetat e mbushura me municion gjerman. Nga çasti në çast do të shikoja flakën nga gryka e tij, ndërsa lugina do të jehonte nga breshëritë e gjata «krr...gu...gu...gu». Edhe larg po të ishin partizanët, kur dëgjonin këto të shtëna, thoshin më vete: «Eshtë mitrolozi Shars i Lymit».

Bënte ftohtë. Qe një ditë shkurti. Qielli, një qiel i kaltërt e i pastër, shkëlqente nga rrrezet e vakëta. Thëllimi të thante fytyrën dhe pjesët e zbuluara të trupit. Partizanët qenë veshur keq: një pjesë ishin zbatur, disa pa kapota.

Lymi vështroi dhe një herë me dylbitë andej nga dëgjohej zhurma, pastaj bërtiti:

- More, po qënka Durimi me shokët!
- Kush?
- Durimi, po kthehet nga Tirana.
- Për pak e vramë — tha Iloja duke mbyllur kasetat e municionit.
- Ooo Durim! — thirri komandanti me sa fuqi pati.
- Ooo!
- Ç'na ke sjellë.
- Gjithë të mirat, shoku komandant!

Lymi doli nga pozicioni dhe u sul në drejtim të karvanit. E pashë tek u përqafua me Durimin, me shokët e tjerë sikur të kish muaj të tërë pa u parë me ta. Ashtu ishte ai gjithnjë, i dashur me të gjithë.

- Si janë shokët andej nga qyteti?
- E kanë ca vështirë, por mbahen si trima — tha Durimi duke mbledhur dorën si grusht.
- Çfarë na ke sjellë, Durim? — e pyeti Lymi.
- Veshmbathje gjermane: rroba, kapota. Bëmë një aksion me njësitin gueril mu përpara hundëve të nazistëve. E ngritëm pothuajse tërë depon.
- Ju lumtë, o shokë! — tha Iloja fjälëpakë.
- Tani do vishemi si gjermanë — thashë unë duke qeshur.

117

46364 SHEN  
DILBERG  
DILBERG

— Mos na marrin për nazistë — bëri shaka  
dhe Iloja.

Atë çast Durimi i dha Lymit një pako të  
mbështjellë me beze ngjyrë kafe.

— Merre, e ke nga nëna.

Komandantit i qeshi fytyra.

— E takove?

— Po.

— Si është me shëndet?

— Shumë mirë, veçse mendjen e ka tek ti.

— Të gjitha nënët ashtu bëhen merak — tha  
Lymi disi i mallëgjyer.

Komandanti qëndroi për një çast përpara pa-  
kos së mbështjellë, i menduar. Pastaj e mori, e  
hapi duke picërruar sytë dhe na ftoi sa ishim aty.

— Hajdeni, shokë!

Gurabijet fluturuan nga dora në dorë. Ishim  
të uritur. Duke përtypur gurabijet e shijshme të  
nënës së Lymit, mendja më fluturonte në fshat, te  
nëna, te kujtimet më të bukura që më lidhnin me të.

— Meti! — më thirri komandanti.

— Urdhëroni.

— Merri këto çorapë, janë të tuat.

— Jo, nuk i marr, shoku komandant. Ato t'i  
ka dërguar nëna dhe...

— Këto që kam veshur çojnë dhe disa ditë,  
kurse ti shiko si i ke...

Vështrimet e partizanëve u ndalën mbi këmbët  
e mia. Këpucët më qenë bërë copë-copë, kurse nga  
çorapet mezi kishin mbetur disa fije leshi të lyer  
me baltë.

— Le t'i marrë Iloja, ai është më keq se unë.

— Edhe Iloja do marrë. Mos ki merak. Te hani

i Priskës do ndajmë veshmbathjen e nazistëve që na ka sjellë Durimi.

Atë natë qëndruam te hani i Priskës. U veshëm që të gjithë me rroba gjermane. E ndjenim veten më të ngrohtë dhe bënëm shakara me njëritjetrin. Partizanët u shpërndanë nëpër baza. Mua më takoi të flija në një bazë me komandantin e kompanisë. Po rrija pranë vatrës me zjarr, mbasi nuk më zinte gjumi. Lymi erdhi vonë pasi strehoi të gjithë shokët nëpër shtëpia. U ul pranë zjarrit, i lodhur nga që pat bredhur tërë ditën e ditës.

— Pse nuk fle? — e pyeta.

— Do të ngrohem ca, o Meti.

Shtriu pëllëmbët e duarve drejt flakës, duke i kthyer herë pas here, për t'i ngrohur. Nën dritën e flakës Lymi dukej akoma më i ri, gati si një çunak. Kaçurrelat e zeza i mblidheshin mbi ballë, të rregullta dhe i jepnin kokës së tij një bukuri prej statuje. Sa më tepër i shikoja aq më tepër më bënин për vete hunda e tij e drejtë, mbi të cilën takoheshin, si dy harqe, vetullat e zeza dhe sytë e gjallë me vështrim të ëmbël. «Komandanti ynë i ka shokët të rrallë» mendova tek e vështroja nën dritën e flakës.

— Shoku komandant, sot u lodhe — i thashë me zë të lartë.

— Jo, Meti. Ne partizanët nuk kemi nge të lodhemi.

— Kam kohë që dua të të pyes për një gjë — vazhdova unë me timen.

— Pyetmë, o Meti.

— Desha të di, ashtu kot... si u lidhe me luftën.

Komandanti qeshi.

— Ashtu si u lidhe ti dhe mijëra të tjerë, o Meti. Unë isha punëtor në qytet, kurse ti fshatar, por lufta na bashkoi ne dhe të gjithë ata që duan të luftojnë armikun e tradhëtarët. Armiku është i fortë, dinak por ne duhet të jemi më të fortë. Kupton, Meti?

— Kuptoj, shoku komandant. — u përgjegja duke e vështruar në sy.

— Kur isha në Tiranë dëgjova të flitej në popull për komunistët, për trimëritë e tyre. Më hipi në kokë të takohesha me këta njerëz, t'i njihja e të bisedoja me ta.

— I takove?

— S'ishte punë e lehtë t'i takoje.

Një ditë në muret e bashkisë kishin ngjitur drapër e çekan. «Këtë e kanë bërë me siguri komunistët» thashë me vete. «Duhet të bashkëpunoj dhe unë me ta».

— A i gjete? — pyeta përsëri me një mënyrë krejt naivë.

— Rrija, prapa portës, ku prisja me orë të tëra, deri në orët e vona të natës, me shpresë se mos vinte ndonjë komunist pér të hedhur trakte. Do t'i lutesha të më merrte me vete pér ta ndihmuar në punët e partisë.

E vështroja komandantin me një farë habie. Lymi shtriu këmbët mbi vatër, sikur t'i ishin mpirë, fërkoi duart e ngrohura dhe vazhdoi:

— Nuk munda të takoj as edhe njerin. A e di se q'bëra, Meti? Fillova të punoj vetë. Mblidhja traktet që hidheshin dhe i shpërndaja nëpër shtëpi e nëpër popull, nisa të vë nëpër shtylla drejtë e çekanë ose bleja bomba me të cilat stërvitesha në afersitë e malit Dajt...

Nuk di se si ngjau më vonë, por e vërteta  
është se që të dyve na kish zënë gjumi, aty pranë  
vatrës së zjarrit. Më kujtohet se u zgjova disi i tre-  
mbur nga zëri i rojës partizane që i thërriste:  
Lymit:

— Shoku komandant, ka ardhur një korier  
nga shtabi.

3

Në letrën që solli korieri shkruheshin këto  
fjalë: «Të zihet me nxitim qafa e malit, mbasi  
andej do të kalojnë forca gjermano-balliste».

Filluam marshimin në natën e kthjellët e të  
ftohtë. Një yll u këput dhe u tret në errësirë,  
prapa malit.

— E pe?

— Kë?

— Yllin që u këput.

— Po.

— Andej nga ne thonë se kur këputet një yll,  
vdes një njeri — shpjegova unë.

— Gjepura! Ne të varfërit gjithmonë na kanë  
ngopur me budallallëqe të këtilla — u përgjegj  
Lymi.

— Ashtu, vërtetë — thashë përsëri me një  
gjysmë zëri.

Lymi shpejtoi çapin dhe doli përpara. Nga  
pas e ndiqte Iloja me kasetat të mbushura me mu-  
nicion. Mitrolozi Shars shkëlqente nën rrezet e  
hënës mbi supin e komandantit. Këtë armë ai e  
njihte me sy mbyllur dhe vështirë se gjeje njeri  
që ta zbërthente e ta mbërthente më mirë se ai.

Kur iu afruam qafës së malit, në afërsi të pyllit, një zë i fortë na ndali në vend.

— Ndal! Kush kalon?

Zëri u dëgjua përsëri, kërcënues:

— Parullën!

Limi bëri një hap përpara dhe vendosi Sharsin në pozicion luftimi, pastaj thirri:

— Berati! Kudër parullën?

— Burreli!

Ishin partizanët e një patulle që patën zënë vend aty për t'u prerë rrugën forcave gjermano-balliste. Në atë pyll zumë pozicione edhe ne. Komandanti na jepte kurajë, bisedonte me shokët, bënte shakara. Kur kalonte pranë meje, i vështroja dhjetëshen e tij të dashur, që i varej në brez dhe me të cilën kish asgjësuar spiunët më të rezikshëm nëpër rrugët e Tiranës.

Lufta filloi në mëngjiez herët, një luftë e rreptë për jetë a për vdekje. Nga pozicioni, ku luftoja, breshëritë e Sharsit të Lymit më jepnin zëmër.

— Krrr... gu... gu... gu...

Pas dy ore luftimi Sharsi nuk u dëgjua më. U shqetësova. Hodha vështrimin nga pozicioni i Lymit, por më pengonin të shihnja mirë disa kaçube që ngriheshin përpara meje. Ç'të kishte ngjarë? Mos vallë qe vrarë?

— Sharsi s'po dëgjohet më, Durim.

— Ndoshta komandanti ndërron pozicion — m'u përgjegj Durimi.

— Kaloi një kohë e gjatë.

— Vazhdo të luftosh, o Meti!

— Mos i ka ngjarë ndonjë gjë?...

— S'e zë plumbi atë.

C'është e vërteta, ai dintë të ruhej nga plumbi

bat. Këtë e kishim vënë re të gjithë, ne, partizanët e çetës. Ndërkokë lufta vazhdonte e rreptë midis nesh dhe forcave gjermano-balliste. Këta përpique-shin të çanin rrugën për të kaluar në fshat, ndërsa partizanët luftonin me këmbëgulje. Qafa e malit dhe pylli oshëtinin nga të shtënët e lloj-lloj armëve, nga krismat e granatave, që lëshonin, kur pëlcisin, një flakë të kuqe dhe pastaj tym të zi. Di që kishim disa orë që po luftonim, por se sa nuk mund ta them. Mendja dhe zemrat tonë qenë përqëndruar në këtë dyluftim të ashpër dhe ne përpinqeshim që të fitonim. Atëhere, në luftë, ne po provonim disa forca në një kohë: armët, moralin, guximin dhe trimërinë partizane.

— Krrr...gu...gu...gu...!

Ftyra më qeshi përnjëherë. «Sharsi i komandanit filloj të këndojet» — mërmërita me veten time. Ai ishte aty midis nesh, i gjallë dhe luftonte. Forcat m'u përtérinë. Shënova një gjerman dhe e lashë shakull në vend. Pastaj një tjetër. Lufta u ndez më e rreptë në krahun e majtë. Ndërrova pozicion për të ndihmuaf shokët e asaj ane. Atje u ndesha me Lymin.

— Shoku komandan, ku ishe?

— Mitrolozi pësoi një difekt. U përpoqat rregulloja, por s'që e mundur. Vajta deri në fshat e më në fund te një armëtar, e rregullova.

Dëgjoje tanë sa bukur që punon—dhe i shkeli këmbëzën.

Pylli oshëtiu.

— Krrr...gu...gu...gu...

— Mendova se të vranë.

Ai qeshi dhe më shtrëngoi dorën.

— Shoku komendant, po afrohet një grup me

fricër — thirri Iloja duke treguar me dorë.  
Lymi vuri dylbitë në sy.

— Leri të afrohen. Atyre as që u shkon ndër mend se kanë rënë në grackë.

— Më duket se nuk na njohin, mbasi jemi veshur si ata — tha Durimi nga pozicioni.

— Krrr...gu...gu...gu...

Nga ana e gjermanëve u dëgjuan rënkimë. Disa s'lëvizën më nga vendi. Nja dy të tjera bënë disa hapa dhe pastaj u përplasën për tokë.

— Na e muarën të keqen! — tha Iloja me shaka.

Duke sulmuar në thellësi të gjermanëve, pak e nga pak u shkëputëm nga forcat tona kryesore. Lymi printe përpara i qetë e gjakftohtë, sikur të mos ishim në luftë, por në gjeti. Nga disa shqope dualën disa gjermanë të armatosur me automatikë.

— Shikoni andej — thirra unë.

— Qënkan shumë këta fricët!

— Jemi të rrëthuar.

— Duhet të çajmë rrëthimin! Takimi në vendin e caktuar.

Armët tona vollën zjarr. Fricët u përgjegjën. U ndez një luftë e rreptë me të shtëna automatikësh dhe plasje bombash. Pylli gumëzhinte, ajri u mbulua më pluhur duke qëndruar mbi kokat tona si një re pluhuri e dendur ngjyrë dheu.

reja e pluhurit, ne humbëm njëri-tjetrin, në mes të pyllit. Ç'drejtim do të kishin marrë shokët? Mos isha shkëputur vetëm unë? Po Lymi ku gjendej? M'u kujtua urdhëri që pat dhënë: takimi në vendin e caktuar. Pra duhej të bëja përpjekje për të arritur atje. Vendosa një karikator të mbushur në automatik dhe fillova të lëviz me kujdes, duke përgjuar. Për një çast erdh e u bë një heshtje e tillë që më futi në mendime. Ecja me automatikun përpara, me gishtin në këmbëz, gati për ta tërhequr. Bëja disa hapa e qëndroja. Mbaja vesh. Shushurima e pyllit më rrëthonte nga të gjitha anët. Rrugës u ndesha me një burim. Pran tij qenë flakur disa kuti konserve të porsaçelura «Këndej kanë kaluar gjermanët» thashë me vete. Atëhere kuptova që kisha uri dhe etje, por bukë nuk më ndodhej. Ju afrova burimit dhe u përkula për të pirë. Në cipën e qetë të ujit pashë të pasqyrohej një njeri pa bustinë në kokë e me tesha gjermane. U çova menjëherë dhe rrëmbeva automatikun. Pranë meje s'kish tjetër njeri. Atëhere u kujtova se qeshë veshur si gjerman, me një xhaketë që më rrinte disi e madhe për trupin tim të imët. Qesha me vete. Shova etjen me ujin e pastër të burimit dhe u çova. Cipa e ujit u mbulua me rrathë të vegjël që niseshin nga qendra e mbaronin në anët e pellgut. Atëkohë dëgjova disa të shtëna revolveri që nga larg. Qëndrova dhe mbajta vesh. Asnjë zhurmë veç shushurimës së pyllit që më rrëthonte. Lart, qielli qe i kthjellët. Rrezet e dieillit futeshin në pyll pjertas, si fashjo të gjera drite, e ndriçonin gjethet, drurët me jë dritë të praruar. «Sa bukur!» u çudita. Bukuria e pyllit më rrëmbeu për një çast. Gjithmonë natyra më ka tèr-

hequr, ajo ka qenë një dobësi e imja. Por kjo nuk zgjati më shumë se sa një çel e mbyll sytë. Rrëmbeva automatikun nga sopi, ku e kisha vendosur dhe e vura në lëvizje. Eca më orë të tëra pa u ndeshur me njeri. Duke ecur sillja ndër mend luftimet që ishin zhvilluar, Lymin që printe me Sharsin, granatat që pëlcisnin, fricët e vrarë që rrënkonin nga dhimbjet dhe shokët partizanë. «A do mund të takohem me ta?—mendoja. Po me komandanatin e kompanisë?» M'u kujtuan të shtënët e revolverit në pyll. Ç'donin të thoshin ato? Mos vallë e kishin vrarë atë që i përdorte si lojë fëmijësh të gjitha llojet e armëve: mitrolozin grek, mitrolozin Breda, Sharsin, pushkën e të gjitha tipet e automatikëve?

Mbas dite i takova shokët në vendin e caktuar. Atje gjeta Durimin, Ilon dhe gjithë të tjerët. U përqafova me ta, i gëzuar sa stregohet.

— Fituam! — më tha Durimi.

— Gjermanët e ballistët e thyen qafën — shtoi Iloja fjalëpakë.

— Komandanti ku është? — i pyeta.  
Ata heshtën.

— Lymi nuk ka ardhur? — gishtërinjt e mi shtrënguan fort krahun e Durimit.

— Jo!

— Është frikë mos ka mbetur i vrarë — tha një djalosh i ri nga Priska.

Askush nuk u përgjegj. Në fytyrat tona lexohej qartë mbresa e dhimbjes dhe e dëshpërimit. Partizanët heshtnin dhe s'kishin dëshirë të flisnin. Të shqetësuar, ata hidhnin vështrimet nga pylli, nga qafa e malit. Muzgu i mbrëmjes që po afrohej e shtonte më tepër këtë ankth.

— Po vjen komandanti!

Ky zë na shkundi që të gjithëve. U kthyem  
andej nga u dëgjua zëri. Vështrimet tona u për-  
qëndruan mbi Lym Ketën që afrohej i qeshur, me  
dhjetëshen në brez, sikur të mos kish ndodhur  
asgjë.

— Asnjë të plagosur?

— As edhe një!

I rrethuar nga ne, ai u ul për tokë.

— Shokë, kjo është fitore! Gëzohem pa masë  
që u takuam përsëri. S'di si na ndodhi që në luftë  
e sipër humbëm njeri-tjetrin. Lufta i ka këto gjëra.  
Kur u gjenda vetëm, vura re se automatiku që  
i zbruzur, kurse bombat e dorës më qenë mbaruar.  
Duke ecur u ndesha ballë për ballë me një oficer  
nazist «Tani do t'më vrasë — thashë me vete»,  
kur aty për aty m'u kujtua se kisha dhjetëshen  
në brez. Si e harrova? E nxora me të shpejtë dhe  
e shtriva për tokë.

Mbas tij më sulmuani nazistë të tjerë. Qëllova  
dhe mbi ta duke u mbrojtur me kujdes nëpër pyll.  
Dhe ja, në fund, tek u takuam të gjithë pa asnjë  
humbje. Kjo është fitore, shokë!

**Shtator 1967**

## DIKUJT I NGJET KJO HIJE

Ushtar Petrit Bodlli me armën mbi sup dhe kundërgaz marshonte me togën për në poligonin e qitjes. Bënte vapë e madhe. Poligoni qe futur në një luginë të thellë, me shkurre e me ndonjë pemë të rrallë. Rrezet e diellit kishin ngrohur faqet e kodrave të zhyeshura dhe ngrinin nga toka një avull të hollë e të përhimët që të merrte fryshtë. Petriti me ushtarët e togës vështronin poshtë në drejtim të fushës, ku spikatnin dy ngjyra të forta: e gjelbërtë e pemëve dhe e verdha e kashtës së grurit që sapo ish korrur. Ushtarët ecnин të lodhur nga marshimi e nga vapa. Djersa i rridhët nga balli nëpër faqe e u mblidhej në trajtën e një pike të trashë në fundin e mjekrës, ku, pasi lëkundej për disa çaste, binte pastaj mbi pluhurin e thatë të tokës që përvëlonë.

Toga iu afrua poligonit. Njerëzit muarën urdhër të uleshin nën hijen e një ulliri.

Komandanti dha urdhër të fillohej qitja.  
— Për luftim!

Dy ushtarë vrapiuan nga baza e nisjes, duke mbajtur njëri mburojën, ndërsa tjetri shtratin

e mitralozit. Ata vraponin nëpër transhenë e ngushtë të ndjekur nga hija e tyre hap pas hapi, bënин një kthesë dhe futeshin në blindazh.

Pas pak u dëgjuat krisma me breshëri të shkurtëra.

— Ta-ta-ta, ta-ta-ta!

Po ta vije re mirë Petritin, ai nuk ish më i qetë. Përcillej herë pas here i mallëngjyer. Atëhere i shikoje fikthin e fytit që i ngrihej e i ulej. Si do të dilte në qitje, me mitralozin e vet? Do ta pengonte vallë difekti që kish në syrin e majtë, qepalla e të cilit nuk mbyllej kur dëshëronte? Kjo që një e metë që e kish trashëguar që në vogëli, kur kish qenë i sëmurë. Dhe ky difekt gjithmonë e kish penguar në qitje. Ja pse shqetësohej Petriti. Qitja është një ngjarje e shënuar për ushtarin dhe secili dëshëron të dalë mirë ose shkëlqyeshëm. Në fund të fundit tabela e qitjes nuk është vetëm një copë dërrase e thjeshtë, por një gjoks «armiku».

Ju afrua komandantit të togës:

— A më lejoni ta lidh syrin e majtë, shoku komandant?

Djaloshi i pakët e me pistoletë në brez buzëqeshi.

— Unë mendoj të bësh qitje ashtu siç je, — tha oficeri.

Komandantri e kuptoi shqetësimin e Petritit. «Eshtë ushtar i mirë e me sedër» mendoi.

Petriti doli mirë në qitje. U gëzua si një fëmijë i vogël kur i sjellin ndonjë lojë të re me rastin e ditëlindjes. U gëzuan dhe shokët e tij. Kurse plumbat e Rustemit vajtën u përplasën mbi faqen e kodrës, prapa tabelave, pa prekur asnjérën prej tyre. Kjo ndikoi në uljen e notës së

togës. Ushtarëve nuk u ardhi mirë. Rustemi qëndronte pranë tyre dhe shikonte majat e këpucëve.

— Do të kishim zënë vendin e parë po të kish qitur mirë dhe Rustemi — tha Xhaçka.

— Ç't'i bëjmë Rustemit!

— Pse, nuk doja unë të delja mirë? — u përgjegj Rustemi duke luajtur nga vendi. — Kush është ai qorr që nuk do sy? — Vazhdoi duke i shikuar të gjithë një e nga një.

— Duhet të jesh më i vëmendshëm.

— Ju thashë që kam dhe një hall: në shtëpi kam gjyshen të sëmurë.

Ushtarët u panë midis tyre, por nuk folën. Atë kohë Xhaçka mbante një fije bari në gojë dhe e përtypte me nervozizëm.

Atë natë i zuri gjumi shpejt, pasi qenë ladhur nga stërvitja. Vetëm Petriti s'i kish mbyllur sytë. Rrinte i shtrirë hë kurri dhe vështronë yjet që xixëllonin.

Petritit iu rënduan qepallat nga gjumi. Duke dremitur, dalloj si nëpër tym një hije që bariste poshtë e lart. Ishte roja. Petriti u mundua të sillte ndër mend ku e kishte parë atë hije me shpatulla të kërrusura. Diku e kishte parë. Hija u ndal një copë herë në vend, pastaj u ul në gjunjë pranë mitralozëve të rreshtuar. Petriti dëgjoi ca tinguj të lehtë metalikë. «Sistemon mitralozët» — mendoi me vete dhe iu kujtua edhe një herë çasti kur, gjatë qities tërhoqi këmbëzën dhe shkrepit batareja.

Buzëqeshi nëpër gjumë «Prova e parë — mendoi. — Nesër duhet të dalim më mirë.» Pastaj çeli përsëri përgjysmë sytë dhe pa hijen që ishte ngritur dhe bariste poshtë e lart:

Kur u kthyje toga nga qitja, fytyrat e ushtarëve

dukeshin të zymta e të mërzitura. Djersët, që u rrëshqisnin nga vapa, e theksonin më tepër dëshpërimin e tyre. Ushtarët vendosën mitralozët në tokë dhe u ulën nën hijen e ullirit të lashtë. Ishte kohë dreke.

Petriti theu heshtjen i pari.

— Sot u turpëruam!

— Asnjëherë s'ka ngjarë që toga jonë të dalë kaq keq — tha ushtar Xhaçka.

— Unë nuk e marr vesh këtë — tha i zemëruar djaloshi me mustaqe. — Dje dolëm mirë, sot shumica s'mori asnjë pikë.

— Qitja është punë me fat — tha Rustemi me sytë pér tokë. Dukej i menduar dhe i mërzitur.

— Jo — tha komandanti. — Këtu s'ka të bëjë fati, por syri, dora dhe mjeshteria e ushtarit. Kjo që na ndodhi sot nuk mund të shpjegohet kaq thjeshtë.

— Edhe një herë kur fillova të kryeja shërbimin ushtarak... — shpejtoi të shpjegonte Rustemi, po komandanti i preu fjalën.

— Leni historitë tani!... Merrni e pastroni mitralozët... Petriti mori në dorë mitralozin e vet dhe u ul në hije. I hapi kapakun dhe filloi ta zbërrthente. Duke vënë në radhë veglat mbi një pece të pastër, e rrotulloi mitralozin nga të gjitha anët dhe e mbajti para fytyrës sikur donte të bisedonte me të. Dhe thoshte me vete:

«Pse u turpëruam sot kështu?»

— Kjo është e çuditshme! — tha pastaj me zë.

— Çfarë? — pyeti Rustemi përnjëherësh.

— Kjo, që dolëm keq në qitje.

— E, o derëzi! Stërvitje po bëjmë; se mos jemi në luftë të vërtetë. Atëhere...

Ushtari mustaqezi që ishte më lart, foli i zemëruar duke tundur me gisht thepin e mitralozit të vet.

— Mor, po kush na i ka lëvizur thepin e mitralozit? Sikur i ka ngarë njeri me dorë!

Të gjithë kthyen kokën andej. Thepi me të vërtetë lëvizte. Ishte liruar. Ushtarët kontrolluan mitralozët e vet.

— Edhe timin... — tha Petriti.

— Edhe timen — u hodh Xhaçka.

Pjesa më e madhe e mitralozëve e kishin thepin të luajtur.

— Prandaj dolëm keq në qitje! — i shkëlqyen sytë djaloshit me mustaqe, sikur kishte zgjidhur një problem të vështirë.

— Shoku komendant! — thirri Xhaçka dhe i shpjegoi ç'kishte ndodhur.

— Ky është sabotim — tha Rustemi pas krahëve të komandantit. Komandanti ngriti kokën dhe i shikoi një nga një në sy. Rustem Asllani nxori shaminë e fshiu djersët në ballë e mbi sy.

— Po thérres teknikun e armatimit t'i kontrollojë. Mos i lëvizni armët — tha komandanti dhe iku.

Ushtarët ngelën të shtangur. Rustemi u ul në gjunjë, tundi kokën dhe tha me keqardhje.

— Kjo është poshtërsi, për nder, poshtërsi!

Kontrolli vërtetoi se thepat ishin lëvizur dhe të gjitha plumbat në këtë gradim binin disa metra lart. Një ditë më parë armët kishin qenë në rregull teknikisht.

«Si nuk na shkoi në mendje? — tha me vete Petriti. — Tani sigurisht komanda do të bëjë punën e saj, po ne... ne ç'bëmë? Kush mund ta ketë bërë këtë? Sigurisht njeri nga ne!» — ai ktheu

kokën dhe në gjysmërrësirën e buzëmbrëmjes shikoi një nga një ata që rrinin përreth.

Dikush erdhi dhe iu ul pranë. Petriti as që e ktheu kokën të shikonte kush ishte, aq kish rënë në mendime.

— Eh, taksirate! — tha burri që erdhi pranë. Petriti e njoihu nga zëri që ishte Rustemi. Nuk i pëlqente ky tip që i mbante sytë në dhe.

— Si u bë puna? — pyeti Rustemi.

— Ç'punë?

— Ajo e thepave të mitralozëve. U gjet apo jo?

— Do të gjendet patjetër — tha Petriti — Janë gjetur gjëra më të mëdha.

— S'dihet, mund të kenë lëvizur edhe vetë nga qitjet e djeshme, apo jo?

S'e di. Tekniku tha se nuk lëvizin kurrë vetë.

— Hej, taksirat, o taksirat — pshëretiu Rustem Asllani dhe u ngrit. Ai u largua në errësirë dhe Petriti e ndoqi me sy gjersa u zhduk tutje. Dëgjoi zërin e tij që i thoshte dikujt poshtë. «S'kam kohë se do të marr shërbimin tani. Jam roje».

Duke parë hijen e tij, Petriti ngriti kokën sikur u përmend nga ndonjë ëndërr.

«Ku e kam parë këtë hije të kërrusur? — mendoi — Po, atë natë në xhade, dhe... mbrëmë kur po më mundonte gjumi. D.m.th. është hija e Rustemit! Hej dreq, ku më shkon mendja edhe mua? Thepat e mitralozëve janë prishur natën, me siguri; kush mund t'i prishte? Pranë armëve kishte roje. Roje? Roje ishte edhe kjo hija e Rustemit. Por roje ishin edhe dy të tjerë gjatë natës. Kush ishte? Xhaçka! Jo, është e pamundur të bëjë një gjë të tillë. Avniu? Jo, jo. Ai është komunist. Po këtë duhet ta ketë bërë një nga rojet e natës. Pse

u përkul ajo hija pranë armëve mbrëmë? Po, po, më kujtohet mirë se dëgjova edhe zhurmën që bënë armët duke u përpjekur me njëra-tjetrën. Pra më shtyn dyshimi vetëm tek ai!»

Petritit i dhimbte koka nga mendimet. U ngrit për gjysmë nga vendi ku ishte shtrirë; shokët të gjithë kishin rënë në gjuinë. Nata xixëllonte nga yjet. Hëna shkëlqente. Dëgjoi hapa më poshtë: Ishte roja. Po, përsëri ajo hija e kërrusur bariste poshtë e lart. Ishte ai, Rustemi... ai patjetër, ai duhej ta kishte bërë sabotimin. Duhej të kthjellonte këtë mendim mirë. Në errësirën e natës Petritit i ndritën sytë dhe iu ashpërsua fytyra. Shtrëngoi grushtet dhe u ngrit në këmbë. Kishte marrë një vendim. Do shkonte të raportonte dyshimet e tij në komandën e repartit. S'bëri as dy-tri hapa poshtë, kur dëgjoi:

- Ndal! Kush kalon?
- Jam unë!
- Ti, Petrit, ej?
- Po.

— Ku shkon kështu? — Rustemi me pushkën në dorë u afrua fare pranë dhe zgjati kokën për ta shikuar më mirë në fytyrë. Petriti u mundua t'i fliste i qetë.

- Po shkoj gjer këtu të marr tamburën me tel.
- Ehe? Ç'farë zevzaku që je!

Petriti pa me bisht të syrit fytyrën e tij të shqetësuar dhe sytë e zgurdulluar sikur kishte net pa gjumë. Pastaj Petriti zbriti poshtë, ndërsa Rustemi ngelj atje në majë të bregores me pushkë në krah dhe me këmbët gjysmë të hapura. Kur u zhduk jehona e zhurmës së hapave të Petritit, Rustemi pëshpëriti «Spiun».

Rustem Asllani nuk fliste kurrë për të kaluarën e vet. Ishte bir kulaku dhe kishte ikur vite më parë nga fshati dhe punonte në fermë. Ai e urrente në shpirt pushtetin popullor, nuk i shikonte dot me sy ushtarakët dhe ushtrinë. Kur erdhi puna në qitje, ai vendosi të hakmerrej në prak të 10-vjetorit të ushtrisë. Dhe iu kujtua një marifet që i kishte treguar plaku i tij për të luajtur thepat. Dhe një natë më parë, duke kryer shërbimin e rojes, kish lëvizur thepat e mitralozëve. Roje ishin tre veta. S'kish si të binte dyshimi menjëherë. Pastaj kush do t'i shikonte thepat? Prandaj Rustemi i ndizej gjaku kur kujtonte atë ushtarin zeshkan e mustaqezi që vajti e preku thepat dhe zbuloi sabotimin.

«Evgjiti!... — shau me vete — Ç'tja bëj se më dhimbset lëkura ime, pa e kisha therur si zogun!»

Filloi të shqetësohej Rustem Asllani. «Tani u trash puna, — thoshte — megjithëse bëjnë sikur s'marrin vesh gjë dhe sikur e lënë punën në hesh-tje, këta të kapin pastaj si miun.

«Pse më dridhet trupi kështu? Ç'bëhem bu-dalla! Jo, jo, po ç'është e vërteta parandjej diçka të keqe. Do të më kapin dhe do të më rrasin brenda. Ç'të bëj?...»

Rustemi vinte rrrotull dhe i avullonte koka nga mendimet. I dukej sikur çdo kaçube fshihte prapa një njeri që e përgjonte dhe do të ngrihej t'i thoshte «Ndal! Je i arrestuar!» Çakarriti sytë dhe ra barkas. I vuri pushkës fishekun në gojë. Dikush u kollit nëpër gjumë. Rustemi u hodh përpjetë i çakërdisur.

Hodhi sytë rreth e qark.

«Do të iki! — tha me vete. — Po ndënja këtu,

në mos sot, nesër jam i humbur. Do të iki, të arratisem, do t'ja mbaj nga fshati dhe andej pastaj...

U rrukullis poshtë me pushkën në dorë dhe mori tatëpjetë pérroin dukë shkelur mbi kaçube e mbi ferra...

... Petriti u çudit kur mori vesh në komandë se dyshimet e tij ishin plotësishët të vërteta. Iu grumbullua në shpirt një urrejtje e madhe pér atë fytyrë dinake që e kishte pasur aq afër dhe s'kishte mundur ta njihte. Prandaj vendosi të shkonte te shokët nga pérroi, qetë-qetë, të ulej diku afër dhe të shikonte ç'bënte ai... Duke ecur me kujdes e pa zhurmë, shtangu në vend, kur dëgjoi hapat që zbrisnin poshtë përroit. U têrhoq mënjanë dhe u fut pas një ferre. Pas pak hapat u dëgjuan fare afër dhe ai, nëpërmes degëve të ferrës, dalloj hi-jen e njojur që ecte, ndalej dhe përsëri ecte. Ai mbante në dorë pushkën.

— Qenka i armatosur! — mendoi Petriti dhe u kujtua që s'kishte me vete asgjë.

Hija u ndal nja dy tri hapa larg dhe ktheu kokën prapa. Në mes të heshtjes, Petriti dëgjonte frymëmarrjen e tij të rëndë dhe, pastaj, ca fjalë të thëna nëpër dhëmbë.

« — Tani ma muarën të keqen!.. Pér dy orë jam në vend...

— Po ikën! — tha Petriti me vete.

Hija bëri edhe dy hapa përpara largoi me dorë ca dega të ferrave dhe u mat të vravonte tatëpjetë.

«Me forcë nuk ma del dot — mendoi Petriti.

— Prandaj do t'i futem vënçe!

Rustemi ktheu vetëtimthi pushkën, po një dorë e fuqishme ja ngriti tytën lart dhe krisma e saj çau qiellin.

— Ç'është? — u dëgjua zëri i Xhaçkës — në-për gjumë.

— Kush u vra? — tha ushtari mustaqezi.

Ushtarët u vërsulën andej nga krisi arma dhe, kur gjetën Petritin që kacafytej me Rustemin, u ndalën dhe u shikuan sy në sy.

— Kapeni qenin — tha Petriti, — ky i kish lëvizur thepat e mitralozëve.

## POSTI LUFTARAK

Detar Agim Batua është një djalë i ri, me trup të imtë dhe pak të shkurtër në krahasim me shokët e anijes, ku ai bën pjesë. Ka një fytyrë të ëmbël si prej fëmije, me dy sy të këndshëm që të shikojnë me vëmendje dhe një nishan të vogël mbi mollëzën e fakes së djathtë.

Në anije ai erdhi në një ditë të ftohtë nëndori. U nis nga fshati herët në mëngjez. Mbi maja e maleve pat rënë dëborë. Ajo dukej nga larg si një qeleshe e bardhë e madhe mbi shpatin e një mali. Bashkë me disa shokë të tjerë u paraqit në Degën Ushtarake të qytetit, hipi mbi një maqinë të mbuluar me mushama të zbardhur nga dielli dhe u nis përrugë. Agimi i struk në një qoshe të kamionit midis rekrutëve që nuk i njihet dhe po mendohej. Përpara mbante torbën me ushqime e lakror që ja kish preqatitur e ëma për t'i ngrënë rrugës. Nuk i besohej se po largohej nga shtëpia, nga shokët, nga kooperativa, i vinte çudi që u gjend para rekrutëve të rinj me koka të qethura, me torba të mbushura me çdo lloj ushqimësh, me duhan të grirë e me fletore. Maqina ecte

me shpejtësi. Bashkë me të rinxjtë këndonte dhe Agimi, bënte ndonjë shaka, qeshte. Sa më shumë merrte pjesë në shoqërinë e tyre, aq më pak e ndjente shqetësimin që i shkaktonte ndarja nga familia, nga e fejuara, nga fshati. Ai e dinte që një ditë do të shkonte në ushtri, sepse ishte detyrë patriotike. Kështu kishin bërë të gjithë djemtë e fshatit: kur arrinin moshën, shkonin ushtarë, të përcjellë nga kooperativistët. Kështu ndodhi edhe me Agimin e shokët e tij. Fshatarët i përcollën deri në të dalë të fshatit, duke kënduar të shoqëruar me fizarmonekë. Agimi u përshëndet me të gjithë, u përqafua me të atin që mbahej pas shkopit prej thane, pastaj me të ëmën që e puthte me dashuri.

- Udhën e mbarë!
- Mirë mbeçi!
- Na shkruaj sapo të arrish.
- Mos kini merak.

E éma e ndoqi me vështrimin e saj plot dhëmshuri. Ndërsa plaku mbahej më të madh, sikur donte t'u thoshte të tjerëve: «Djali po shkon ushtar, e shikoni?» Lumtua, e fejuara, nuk e përcollit dot se i vinte turp. Po ata kishin biseduar gjatë e gierë një ditë më përpara. Ishin betuar se nuk do ta harronin kurrë njeri-tjetrin, se do të shkruanin letra, se ajo do ta vështronë nga dritarja e shtëpisë Agimin kur të shkonte dhe ai do të kthente kokën. Djaloshi, para se të merrte kthesën e kodrës, tek vo largohei nga fshati, ktheu kokën në drejtim të shtëpisë së Lumtos. E dalloj atë në dritare tek e përshëndeste me dorë. Buzëqeshi dhe ndjeu në zemër një kënaqësi të cuditshme që nuk mundi ta harrojë për shumë kohë. Pastaj pylli dhe kodra

e penguan. Ai pëshpëriti me vete: «Mirë u pafshim, Lumto». Hodhi vështrimin nga pylli me pisha të gjelbërtë, me degë plot hala dhe me boçe që i pëlqente aq tëpër. Ndjeu erën e rrëshirës, aromën e barit dhe të dheut të lagur. Disa boçe u këputën nga degët dhe ranë poshtë me zhurmë të mbytur.

Këto mendonte Agimi herë pas here, ndërsa maçina ecte. Ai pa Pogradecin, liqenin e bukur të rrëthuar nga vargu i maleve, kapërceu Qafën e Thanës, kaloi përmes Librazhdit, soditi muret e kalasë së vjetër të Elbasanit dhe aty nga darka arriti në një qytet bregdetar, pranë repartit, ku ishte caktuar. Që atë çast filloj jetën e detarit...

\* \* \*

Ditët e para e pati pak vështirë. Mezi u mësua me ambientin e ri. Mendjen e kishte te shtëpia, te shokët e tij më të dashur. Mendonte Lumton. Shkrojtë mjaft letra, ashtu siç shkruanin edhe të tjerët. I shihte shokët tek rrinjët të kërrusur mbi fletore dhe shkruanin. Agimi i shkrojti së fejuarës. «E dashur Lumto!

Tani që po të shkruaj këtë letër ndodhem në anije, në kubrik. Jam në kohën e lirë dhe mendova të të shkruaj. Anija, ku shërbej unë, është me të vërtetë një gjë e çuditshme. Qëndron në det si një lëvözhgë arre; ndërsa nga dallgët as do t'ja dijë. Me detin e kam ca keq, pasi më zë, por them se do të mësohem. Për ty më merr malli shpesh. Të kujtoj tek punon me shoqet për të hapur gropat, për mbjelljen e patateve, me flokët e zez të mbështjellë me çembejkë të bardhë. Me Murashin

kush punon tan? Eshtë një ka i shëndoshë që nuk di se ç'është lodhja. Më kujtohet kur e çoja në postaf për të pirë ujë. Murashi ecte ngadalë, me ata sy të mëdhenj e të menduar, me jargat që i rrithnin nëpër gojë. Pastaj pinte ujë sa fryhej si kacek, ndërsa unë e ledhatoja në kokë, në qafë. Një ditë pranë postafës u takuam bashkë dhe ti më the: «E ke shëndoshur kaun që të punojë mirë e që të marrësh flamurin». Unë qesha. A të kujtohet? Njëherë tjetër ti u zemërove. Tërë atë natë s'më zuri gjumi deri sa u gdhi. E përsë u zemërove? Pse nuk erdha një të diel në vatrën e kulturës. Atë ditë unë kisha punuar në arë, pasi shokët e brigadës më kishin kritikuar se kisha mbetur pak prapa. Misrin a e mbollët? Cila brigadë e mori flamurin këtë radhë? Po të më pyesin mua, unë do t'ja jepja brigadës së dytë, jo pse je ti atje, po se ka punuar me gjithë mend. Për fshatin më ka marrë malli, bile edhe për gurët e kalldrëmit, kur i thonë fjalës. Qyteti ku jam unë është i madh. Ka detin pranë, ku vinë anije të mëdha nga gjithë vendet e botës, por ke parë ti, Lumto, që para fshatit tonë nuk më duket asgjë?»

Mbresa të mëdha i pat lënë Agimit deti me hapësirën e tij të pafund, me dallgët e shkumëzuara, që ngrihen ndonjëherë gjer te bordi i anijes. Qyteti ish mjaft i bukur, e me shtëpi shumëkatëshe, me rrugë të gjera e të drejta, me fabrika të mëdha, me muret e vjetra të kalasë së hershme. Në port, ku hynin e delnin me dhjetëra anije transoceanike, ngriheshin, njeri pas tjetrit disa vinçë të mëdhenj që ngjanin si me ca kafshë të stërmëdha të kohëve të lashta. Kur u fut në anije për herë të parë, ai u hutua, iu duk sikur qe futur në

një vend të myllur e të ngushtë, ku lëvizjet duheshin kursyer. Atje do të stërvitej, do të flinte; me atë do të çante ujërat e Adriatikut. Por njëkohësisht çdo gjë në anije e bënte kureshtar, çdo gjëje donte t'i dinte emrin, përse shërbente, si punonte. Komandanti i postit luftarak ja shpiegonte që të gjitha Agimit dhe numërorëve të tjerë. Ai shkruante, mbante shënimë dhe pastaj mësonte. Dalëngadalë po futej në misteret e anijes luftarake, njoju motorët e fugishëm, armët, urën e komandimit dhe shumë gjëra të tjera. Mbi të gjitha, përvetësoi detyrat e postit të tij luftarak. Sigurisht nuk e pati lehtë, mezi u mësua me lëkundjet e anijes, me zhurmën e motorëve, me trubullimet që i shkaktonin dallgët, me emërtimin e piesëve të teknikës. Luftoi për javë me radhë me veten e tij. Anija, ku ai stërvitej, që pajisur me teknikë moderne, të ndërlikuar, me aparatura e mekanizma të vështira për t'u mësuar e për t'i përdorur. E me gjithë atë duhej t'i mësonë, sepse vetëm ashtu mund të quhei detar i vërtetë.

Viti i ri e gjeti atë shëniues të dvtë të postit luftarak. Atë mbrëmie e kaloi në kubrik së bashku me detarët dhe oficerët e anijes. Në mes të dhomës kishin vendosur pemën e vitit të ri: një pishë të vogël të mbuluar me pambuk. Duke e parë këtë pemë të vogël, Agimit iu kuitua pylli i fshatit me pisha të larta dhe dëbora që mbulonte malet.

\* \* \*

Anija çan detin e qetë me bashin e mprehtë. Mbi direk valvitet flamuri. Duke e parë atë, Agimi ndjen një farë krenarie. Ai po shkon në stërvitje.

Koha është e bukur, ndërsa deti i qetë vaj. Por de-  
tit nuk i besohet, se ai papritur ze e shqetësohet  
sikur ta ketë zemëruar njeri atje poshtë në shtre-  
sat e thella. Agimi hedh vështrimin në drejtim të  
bregut, ku shtrihet qyteti i bukur me shtëpi të  
larta, të cilat nga anija duken si kuti shkrepshët  
vëna në radhë. Shikon fushat e punuara, kodrat e  
mbjella, tarracat dhe thotë me vete: «Kudo punohet  
si në fshatin tim».

Në urën e komandimit qëndron komisari dhe  
komandanti i anijes.

Agimi është ulur në ndenjësen e topit, gryka  
e të cilat vështron qiellin. Deti përpara është i  
madh, i pafund. Detarët shkojnë në stërvitje. Ai  
është pak i shqetësuar. Në mbledhjen e efektivit  
të anijes, u zotua se nuk do të lëvizë nga posti  
luftarak edhe sikur ta zerë deti. Fjalën e kish thënë  
para të gjithëve, por a do ta mbante dot? Dallgët  
nuk duan t'ja dinë. Ato bëjnë të paaftë edhe  
detarët më të vjetër e më të stërvitur. Po ai? Atë e  
zinte deti. E, megjithatë, donte të kryente dety-  
rën, t'i kapërcente vështirësitë sa më mirë. Posti  
luftarak është në gadishmëri: Të gjithë numërorët  
janë nëpër vende. Zhurma e motorëve të  
shurdhon. Duhet të bërtasësh që të kuptojë shoku  
më i afërt. Kio zhurmë nuk të ndahet as në tokë,  
për një farë kohe. Agimi qëndron në postin e tij  
dhe ndjen se i përzihet, ka përshtypjen e një  
ndjenje të papërcaktuar që e pushton dalëngadalë  
gjithë qënien e tii, zbehet, ndërsa fytyra i mbulo-  
het me djersë të ftohta.

Nata ka pushtuar hapësirën. Anija ecën dhe  
lëkundet. Deti nuk është më i qetë. Fryn erë. Dall-  
gët ngrihen përpjetë e pastaj lëshohen mbi bord

me gjithë fuqinë e tyre. Anija lëkundet, duket sikur do të përmbyset, por nuk ndodh asgjë. Bashi ngrihet, përsëri ulet dhe çan përpara. Dallgë të tjera hidhen mbi kuvertë duke shkumëzuar, lagin detarët, topin, etj. Njerëzit qëndrojnë nëpër vende të bërë qull, të zbehtë, ndonjëri trubullohet. Ata presin urdhër.

Akustiku raporton: «Peleng 120 gradë, distanca 7 kabël, kam kontakt me nëndetëse «armike». Pas tij dëgjohet zëri i shefit OL- 2-3 nga ura e komandimit:

— Llogaritësit e mbrojtjes kundër nëndetseve «armike».

Numërorët lëvizin. Gradojnë thellësinë e plasjes, heqin tirantet e luftimit, vidën e sigurecës, mbyllin mekanizimin e shkrepjes dhe raportojnë:

— Gati!

Pregatitja bëhet shpejt madje shumë shpejt. Agimi mendon se, po të bëhen me ngathtësi lëvizjet, anija do të mos dalë dot në kohën e duhur në atak kundër nëndetses «armike»; kjo do të thotë që ajo të kalojë në ujërat tonë, të bëjë zbulim ose të lëshojë ndonjë diversant.

Por kjo nuk do të ndodhë.

Agimi bën lëvizje të shpejta, ai nuk mendon se është i lagur, se ka të ftohtë. Nxjerr predhën nga depoja dhe e vendos në tirantet. Të gjitha forcat i ka përqëndruar në këto veprime. Duhet zhdukur nëndetsja. Kjo është e gjitha. Por s'është lehtë të asgjësosh armikun. Errësira e natës, dallgët e egërsuara e bëjnë akoma më të vështirë një gjë të tillë. Detarët i ka zënë deti, gjithashtu edhe Agimin. I përzihet, ndjen dobësi në të gjithë trupin; goja i mbushet me lëng. I bëhet se nuk do të

qëndrojë dot. Ka frikë se mos rrëzohet mbi kuvvertë. Po të bjerë, dallgë të mëdha do ta përlajnjë në det dhe ai do të mbytet me siguri. Si të bëjë? Të têrhiqet? Të vejë në kubrik e të shtrihet? Atje është ngrohtë, dallgët nuk do ta kërcënojnë. Por a mund ta bëjë një gjë të tillë, e të lerë detyrën? Ç'do të bëhet me nëndetsen «armike»? Të largo-hesh nga posti do të thotë të dezertosh. Atij iu kujtuan fjalët që kish thënë në mbledhje, para se të niseshin për stërvitje: «Ju premtoj shokëve se nuk do të largohem asnje çast nga posti luftarak».

Agimi u përkiste atyre njerëzve që nuk i ndajnë fjalët nga veprat. Qëndroi në vënd megji-thëse uji i kripur i detit i futej në gojë, hundë e veshë, i përcëllonte sytë. Ai nuk u largua as atëhere kur detyra u plotësua me sukses dhe komandanti OL- 2-3 dha urdhër që detarët të strehohe-shin në kubrik.

Agimi mendoi se nuk duhej ta linte topin e anijes pa e mbuluar me mushama. Përndryshe kri-pa e detit do ta ndryshkte gjë që dëmtonte gadishmërinë luftarake. Ai qëndroi dhe bëri çmos-deri sa e mbuloi atë duke luftuar në të njëjtën kohë edhe me dallgët e zemëruara. Solli ndër mend shëmbullin e Adem Rekës, që u përpoq të shpë-tonte bigën lundruese si dhe Muhamed Shehun e Myrteza Kepin që treguan ndërgjegje e qëndrue-shmëri të lartë kundër vështirësive; ata të gjendur në mes të flakëve, qëndruan dhe ranë heroikisht për të shpëtuar nga djegja stacionin e pompimit. Agimi, e kuptonte se ai nuk bënte asgjë veç dety-rës ndaj atdheut. U kthye në kubrik kur çdo gjë qe në rregull. Atje e kuptoi se ishte bërë qull e mërdhinte. Nxori çantën e shpinës nga komodina

dhe mori tesha të tjera. Atë çast një copë letër u rrëzua përdhe. Ishte letra që i pat dërguar Lumtua nga fshati. E kish lexuar kaq herë atë letër, e, me gjithatë, ashtu siç qe i shtrirë, filloi ta rilexojë edhe një herë.

«I dashur Agim!

Po të përgjigjем pak me vonesë, po më mirë vonë se kurrë. Me shëndet jemi të gjithë mirë, po ashtu dëshëroj dhe për ty. Me sa kuptoj nga letra, ti e kalon kohën mirë në ushtri. E marr me mend që në fillim do ta kesh pasur pak vështirë. Por çdo fillim ashtu e ka. Edhe ne këtej e kalojmë mirë. Punë kemi shumë: punim toke, mbjellje e shumë të tjera. Këto kohët e fundit në fshat u kemi shpallur luftë zakoneve prapanike dhe paragjykimeve fetare. Veç të dëgjoje njerëzit si flisnin në mbledhje. Folën mjaft gra e vajza. Të kujtohet Azeja, ajo gruaja e urtë dhe e mirë, shoqja e Xha Brahos? Ajo foli kaq thjesht e me vërtetësi sa më bëri të derdh lot. Foli për jetën e saj se si xha Brahoja nuk e thërriste asnijëherë në emër, se prindët e patën fejuar që në vogëli për një dorë pare, sikur të kish qenë ndonjë lopë. Veç të tje rave në pajë prindërit e saj nuk harruan t'i venë edhe një copë litar që t'i shërbente për tu ngarkuar me dru e me bucelat e ujit. Në mbledhje u prishën shumë fejesa të padrejta, ndërsa xhaminë vendosëm ta kthejmë në vatër kulture, pse ajo që kemi, sikurse e di, është ndërtesë e vjetër. Tani mbledhjet e rinisë i zhvillojmë në vatrën e re.

Të dielën që kaloi në fshatin tonë u bë një gjyq i çuditshëm. Ú zhvillua në atë lëndinën e bukur ku bëjnë zakonisht mbledhjet. Ishin mbledhur burra, gra e fëmijë. Njerëzit u ulën këmbëkryq

mbi bar, kurse gjyqtarët ndenjën mbi stola të thjeshtë prej druri. U gjykuan: Demkoja që shiti vajzën e tij (Fatimen, ti e njeh) trembëdhjatëvjeçare, dhëndërri, Brahoja dhe lajmësi.

Në këto mbledhje folën shumë njerëz. As unë nuk u mbajta dot. Në fillim më erdhi turp, por pastaj mora guxim. Fola për vete dhe për të tjerët. Edhe unë nuk e di nga më vinin gjithë ato fjalë që thashë. Por për një gjë jam e sigurt; ato më rridhnin nga thellësia e zemrës. U fola njerëzve për zakonet prapanike që na i kanë lënë të huajt: për martesat në moshë jo të barabartë, për shpenzimet e tepërtë nëpër dasma, për festimin e ditëve të shejta fetare, bestytnitë, etj. Në fund baballarët dhe nënënat tonë, pleq ë plaka, dhanë fjalën që në fshatin tonë vajzat të mos fejohen pa mbushur moshën, të mos i shesin ato më parë, mos u jepen pajëra. Burrat thanë se do të braktisin zakonin e keq që gratë ose vajzat t'u lajnë këmbët. Për të gjitha këto ne kooperativistët i bëmë një letër shokut Enver, ku i premtojmë se do të luftojmë për zhdukjen e zakoneve prapanike dhe fetare. Kjo letër u botua në gazeten «Zéri i Popullit» dhe me siguri do ta kesh lexuar».

\* \* \*

Kur rrezet e para të diellit shkrepën të nesërmen mbi kodrat me tarraca të qytetit bregdetar, anija luftarakë u ankorua në breg. Deti ishte qetësuar. Agimi dolli mbi kuvertë dhe vështrimin e ndali mbi flamurin që valavitej në kiç. Mbushi gjoksin me ajër të pastër. Topi qëndronte i mbuluar me mushama në pozicionin që e kish vënë.

1967.

## DY KIRURGET

Shtatori apo kish hyrë, megjithatë ditët ishin të nxehta. Doktor Filip Reka, duke shkuar për në stacionin e trenit, ndjente afshin e ngrohtë që ngrihej nga asfalti i përzier me erën e ziftit të zbutur, kur linin gjurma këmbët e tij. Vështroi orën e do-rës. «Ka akoma dhe 15 minuta» mendoi me vete.

Doktor Filip Reka apo kish mbaruar fakultetin e mjekësisë në Tiranë. Disa ditë më parë e kishin lajmëruar se ishte transferuar në qytetin X, ku do të punonte si kirurg. Gëzimi i tij qe i papër-shkruar. Ç'është e vërteta, ai nuk ishte fillestar në kirurgji. Gati të gjitha praktikat e detyrueshme të fakultetit i kish bërë nëpër repartet e kirurgjisë në Vlorë, Gjirokastër, Durrës. Doktor Filipi njihte gati të gjithë kirurgët më të mirë të Shqipërisë. U dinte aftësitë, u dinte tekat. Vetëm kirurgun e qytetit X nuk e njihte. Kish dëgjuar që ish një burrë rrëth gjashtëdhjetë vjeç, që kish bërë studimet mjekësore në Vienë. Ata që e njihnin, flisnin mirë për të. Tani ai, Filipi, do të bë-hej nxënësi i tij, nga ai do të mësonte profesionin e vështirë të kirurgut.

Dhe ja, më në fund, ishte vendosur që ai të bëhej kirurg. Me sa ankth e kish pritur ditën kur do t'i komunikonin transferimin. Si do të bënte sikur t'i thoshin se do të punonte si patolog? Filipi patolog! As që mund ta mendonte veten e tij në një repart patologjie. Jo se e nënvleftësonte patologjinë, jo, por atij i ishte mbushur mendja se do të jepet më tepër në kirurgji. E pse të mos vihet njeriu në atë sektor pune ku mund t'i japë më shumë shoqërisë? Arësyetimi që bënte i dukej i drejtë. Megjithatë, Filipi e dinte se punët nuk shkojnë gjithnjë ashtu sipas dëshirës së njerëzve.

Tani kjo frike i kish kaluar. Atij i gufonte zemra nga gezimi që po nisej për të filluar punën sp kirurga. Do të njihet me kolektivin e mjekëve, me drejtorin, me shefin e kirurgjisë. Rruga do të ishte e gjatë, e vështirë, plot zikzake. Cili kirurg u bë i zoti brenda katër pesë vjetve? Shpesh e shikonte veten në enderr, kirurg të madh, që e respektion dhe e dëgjonin të gjithë. Asnjëherë nuk gabonte. Vetem vizitonte, operonte. Shumë herë, sigurisht në enderr, e thërrisin edhe në Tirane për të operuar raste kirurgjikale teper të vështira.

Por, tani që po nisej, bashkë me gezimin sepse i përzihet dhe nje farë pasigurie. Si do të ekte ai në kirurgji? Do ta përvetësonte shpejt tekniken e të operuarit? Nuk ishte më student në mjekësi, por që berë mjek. Instiktivisht, dora i vajti në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe preku aty diçka të forte në formën e një fletoreje të vogël diploma. Ajo ishte aty në xhep.

Treni u nis me dhjetë minuta vonësë. Këto dhjetë minuta mjekut iu dukën të gjata. Desh që treni të lëvizte nga vendi, të ikte sa më shpejt.

Sirena çau është e ngrohtë. Treni lëvizi, në fillim ngadalë. Filip Reka po largohej nga Tirana, ku kish studjuar pesë vjetë përtu bërë mjek. Tani fillonte një shkollë tjetër më të vështirë, shkollën e jetës, praktikën.

Kur arriti treni në stacionin e qytetit X, Filipi mori valixhen, zbriti nga vagoni dhe filloi të kërkojë midis njerëzve. Dikush e thirri me forcë e Filip! Filip!

Undal. Ishte Agroni, shoku i tij i ngushtë, që punon të në spitali si patolog. Para se itët nisej, i kish bërë një telegram: «Transferohemi në spitalin tuaj. Vlij sonte me trenin e orës 18.00 Filipi». Dhe ja tek paskish dale ta priste Agroni i kishte mbaruar studimet dy vjet më parë se ai e megjithëse nuk kishin qenë në një klasë, ata kishin zënë miqësi dhe qenët bërë shokë.

U përqafuan

— Thashë se nuk do të më prisja!

Agroni buzëqeshi.

— Si mos të të prisja! Kirurgun i tifamë Filip Rekën?

— Fillove nga shakatë?

— Në mos je i madh, do të bëhesh.

Qeshën të dy. Aitja dinte zakonin Agronit prandaj dhe nuk iu zemërua.

— Duhet të zë një vend në hotel.

— Je në vete? Sonte do të flesh në dhomën time.

\*\*\* — U është laju mëk!

Në mëngjez, kur hapi sytë, Filipi vuri re se krevati i Agronit ishte bosh. Pa orën: tetë e gjysmë.

— Nuk ka dashur tē më zgjojë — mendoi me vete. Mbi tryezë gjeti një copë letër me këtë shënim: «Nuk po tē zgjoj. Fli dhe sot, pëllumbi im i vogël, se pastaj do tē zgjohesh qđo ditë në orën gjashtë. Të pres në spital».

Spitali qe ndërtuar në tē dalë tē qytetit, i rrethuar nga tē katër anët me mure tē larta. Mbi një derë tē madhe prej hekuri ngijyer me bojë tē bardhë ishte një tabelë ku shkruhej me shkronja tē bukurë: SPITALI CIVIL.

Portieri, një azmatik i vjetër, e ndali te dera:

— Po ju ku shkon?

— Kam punë me drejtorin.

Plaku i hodhi një vështrim nga këmbët te koka.

— S'është ora për takim tanë, mor shok. Doktorët janë duke vizituar tē sëmurët.

— Unë jam mjek; jam transferuar këtu dhe...

Plaku e vështroi më me vëmendje.

— Mjek jeni ju? Atëhere ndryshon puna.

Urdhëroni.

Trokiti në derën e drejtorit që sapo ishte kthyer nga pavioni.

— Hyrë! — u dëgjua një zë.

Drejtori i hodhi një vështrim tē shpejtë sikur desh tē thosh. «Të lutem, thuaj q'ke për tē thënë, por vetëm shpejt».

— Unë jam...

— Keni njeri tē shtruar në spital? — e ndërpren ai.

— Unë jam mjek... jam transferuar në spitalin tuaj.

Drejtori i zgjati dorën.

— Ah, po, ju jeni doktor Filip Reka. Kirurg. Më tha doktor Agroni se kishit ardhur. Shumë mi-

rë. Këto shkresat e shkreta s'të lënë rehat — tha duke treguar dosjen.

— E njihni doktor Masarin? — shtoi pas pak.

— Jo!

— Gjynah! Kemi një kirurg, që rrallë e ka Shqipëria. Teknik i mbaruar. Do ta njihni. Shkon në pavion — ja preu drejtori me të shpejtë si të donte ta hiqte qafe për të vazhduar punën — Doktor Masari është në repart; ju pret atje.

Drejtoria ndodhej në një ndërtesë të vogël disa metra larg nga bloku i spitalit. Kështu që Filipi kaloi nëpër rrugicat e një lulishteje të bukur.

Në hyrjen e ndërtesës, ai sa nuk u përplas me një vajzë të re, flokëverdhë dhe me dy sy të kaltërt. Në dorë mbante disa shishe laboratori.

— Ju lutem, nga ç'anë është reparti i kirurgjisë?

Vajza i hodhi një vështrim djaloshit që po e pyeste.

— Nuk e dini? Hyrja në të djathtë.

Koridori i repartit ishte i gjatë, pak i errët. Nëpër mure qenë varur parulla të shkruara bukur: «Mos bëni zhurmë», «Qetësia shëron», «Mos pësh-tyni përtokë».

Mbi një derë Filipi lexoi: «Shefi i repartit». Trokiti.

— Hyrë — iu përgjegj një zë prej basi. Filipi u ndodh përpara një burri rrëth nja pesëdhjetë vjeç, me një ballë të gjerë dhe me flokë të rrallë. Siç dukej, ky ishte shefi i repartit.

— Deshët gjë?

— Unë... Unë jam doktor Filip Reka; do të punoj në repartin tuaj si...

— Ah! ju jeni kirurgu i ri.

— Po, doktor.

Shefi i repartit vështroi orën e dorës.

— Tani kam vizitën e të sëmurëve. Vishni bluzën e bardhë dhe ejani të shkojmë.

\* \* \*

Ditët e para në spital rrodhën shpejt. Filipi punonte gjer vonë: studjonte kartelat, bisedonte me të sëmurët, bënte vizitën e mëngjezit së bashku me doktor Masarin. Në repart kish të shtruar nga ulçeri i stomakut, të sëmurë nga veshkat, njerëz që kishin thyer këmbët ose duart në aksidente të ndryshme. Në fillim ai qe i turpshëm dhe shumë pesimist. I dukej sikur nuk do të arrinte kurrë të njihte gjithë të sëmurët e repartit. Përditë dhe përnatë shtroheshin të sëmurë. Urgjencat ishin dhe ato të dendura. Gati nuk kishte natë të mos vinin ta zgjonin në dhomën e tij duke i thënë:

— Doktor, ka ardhur një urgjencë. Mjeku i rojes kërkon dhe mendimin tuaj. Siç duket, është një rast kirurgjikal.

Kur vizitonte, thosh të vërtetën përpara të sëmirit, në mënyrë të prerë, pa menduar se i lëndonte shpirtin atij që vuante. Akoma nuk kish mësuar të ngushullonte. Ai nuk e kishte kuptuar se çdo sëmundje është një ngjarje me rëndësi në jetën e njeriut, ajo lë gjurmat e saj në ndërgjegjen e tij. Prandaj, fjalë e mjekut ka rëndësi të madhe, ajo është si thika me dy tehë; ose e qetëson dhe e lehtëson të sëmurin duke e shëruar ose e brengos dhe kështu ngadalson zhvillimin e sëmundjes. Praktika po i tregonte Filipit se mjeku

duhet të dijë të flasë, por edhe të heshtë përpara të sëmurit.

Një mbrëmje, bënte roje doktor Agroni. E zgjoi nga gjumi kryeinfermieri i sallës së operacionit, Astriti.

— Doktor, një të sëmuri të operuar i ka hipur temperatura. Ejani ta shikoni, se doktor Agroni nuk ja thotë dhe aq...

Filipi, siç qe nëpër gjumë, u zemërua.

— Si flisni në këtë mënyrë për mjekët?

— Këtë e thonë të gjithë...

I sëmuri digjej nga temperatura dhe ankohej nga dhimbje të forta në vendin e operuar.

Të dy mjekët e vizituan.

— Abces post operator i plagës! — tha Filipi.

Kjo nuk ishte gjë e rrallë në të sëmuret që operoheshin. Një gjë e këtillë donte të thoshte, se rregullat për ruajtjen e sterilitetit nuk mbaheshin në repartin e kirurgjisë dhe sidomos në sallën e operacionit. Për këtë kishte përgjegjësi dhe kryeinfermieri i sallës, Astriti. Ky shpesh herë futej në sallë pa gazra në fytyrë, pa galloshe llastiku, ose bisedonte me zë duke shpërndarë në ajër spërkla pështyme plot mikrobe. Po doktor Masari pse e lejonte një gjë të tillë?

Një ditë, pasi kishte bërë rojen, i ksh raportuar doktor Masarit se infermierët e natës flenë, se kryeinfermieri lejon që garzat për mjekimin e plagëve të kafen me dorë dhe jo me pinca sterile.

Shefi i repartit qe përgjegjur i mërzitur:

— Volumi i punës është rritur shumë; më mun-  
gojnë kuadro; i kërkoj drejtorisë, por nuk më jep.

— Këtu është fjala për shkeljen e rregullave  
në mjekimet.

— Unë jam shumë i interesuar për këto gjëra, doktor i dashur — e kish mbyllur bisedën doktor Masari. Filipi kish kuptuar se shefi i tij nuk donte të zgjatte më tepër bisedimin. Ishte e qartë se doktor Masari, dashur pa dashur i lejonte vetë këto të meta. Ai nuk kontrollonte punën e vartësve të tij. A duhej vallë të tërhiqej përpara kësaj gjendjeje? Apo duhej të luftonte gjersa të vendosej rregull dhe me këtë të ndihmonte në sherbim sa më shpejt të të sëmurëve? I kujtoheshin fjalët e profesorit të kirurgjisë: «Puna praktike kirurgjikale duhet të ngrihet në nivelin e artit mjekësor».

Keq shkonte puna edhe me analizat e të sëmurëve Edhe ato vonoheshin, bile, ngandonjëherë, humbisnin fare. Të sëmurin nr. 17 doktor Filipi po e përgatiste për ta operuar, por analizat laboratori po i vononte.

— Astrit, analizat e të sëmurit nr. 17 nuk po vijnë.

— Laboratori nuk i ka bërë akoma.

— Si është e mundur! Kanë tri ditë që janë marrë. Kjo do të thotë të mbajnë njerëzit më të pér se sa duhet në spital...

— Po të doni, bisedoni vetë me Dritën, përgjegjësen e laboratorit.

Filipit nuk i erdhi mirë. Njerëzit në atë repart qenë mësuar keq: gjithnjë ja hidhnin fajin një tjetri. «Duhet vajtur në laborator» — mendoi dhe u nis.

Laboratori klinik qe ndërtuar prapa korpusit të spitalit, në një ndërtesë të vogël, në trajtën e një vile të lezeçme. U fut brenda. Mbi mikroskop, pa një vajzë leshverdhë, që po shikonte me kujdës një preparat të ngjyrosur.

E njuhu menjëherë: ishte vajza që kishte takuar ditën e parë në hyrjen e spitalit. Ajo mban te një dorë shishe laboratori.

— Më falmi, shoqe...

Vajza hoqi sytë nga aparati dhe vështroi Filipin.

— Urdhëroni.

— Ju jeni laborantja?

— Unë jam.

Vajza iu duk e bukur Filipit, si atë ditë që e kish takuar te dera e spitalit. Çdo gjë tek ajo, sytë, hunda, flokët, buzët ishin krijuar në harmoni. Maja e hundës shikonte pak përpjetë dhe i jepte asaj pamjen e një vajze çapkëne dhe të përkëdhelur.

— Ka tri ditë që i janë marrë analizat të sëmurit Nr. 17 dhe akoma nuk i kemi përfundimet. Ne nuk mund ta operojmë pa analiza.

— Kemi shumë punë.

— I vonon shumë shoqja laborante.

Dritës i erdhi inat nga mënyra se si i feli doktor Filipi. Ajo u përgjegj:

— Shoku doktor, unë nuk bëj vetëm analizat e repartit tuaj; unë punoj për gjithë spitalin. Prandaj, kur t'ju vijë radha.

— Kjo s'është punë.

— Kështu punojmë ne këtu.

Filipi e pa veten ngushtë. U mundua të mbajë gjakftohtësinë, duke i hedhur një vështrim plot zemërim vajzës së re që qëndronte pa lëvizur pranë mikroskopit.

Doli nga laboratori dhe, ashtu siç qe i nevrikosur, kaloi nga reparti i patologjisë, ku punonte doktor Agroni. Ja tregoi ngjarjen. Agroni queshtë.

— Si të tha, o Filip? «kështu punojmë ne këtu». Ha, ha!

— Do t'i ankohem drejtorit.

— Ajo është vajza e shefit tënd, m'or t'u mbylltë dera, është e bija e doktor Masarit.

Tërë atë natë doktor Filipit nuk i hiqesh nga mendja, që laborantja e pasjellshme ishte vajza e shefit të tij.

\* \* \*

Mbrëmje vallëzimi. Në orën njëzet, salla ishte mbushur me njerëz: mjekë, infermierë, sanitare. Në krye të sallës qëndronin drejtori i spitalit me të shoqen, doktor Naimi, që ishte njëkohësisht sekretar i organizatës bazë, doktor Masari. Filipi dhe Agroni kishin zënë që të dy një tryezë më vete. Doktor Josifi me të shoqen dhe me fëmijët rrinin pas tyre.

Një atmosferë rinnie, këngë dhe gëzimi qe përhapur në të gjithë sallën. Njerëzit bisedonin, qeshnin, pinin, birrë e duhan. Të tjerë vallëzonin.

Drita ishte ulur pranë farmacistes, Verës. Të dyja vajzat nuk ishin të një moshe, por midis tyre ishte vendosur një miqësi e tillë, që krijohet midis një vajze më të madhe dhe një vajze më të vogël. Farmacistja nuk ishte shumë e gjatë, kish shtat të lidhur dhe flokë në ngjyrë gështenje. Duke e parë me vrejtje nuk mund të thoshe se ishte shumë e bukur. Por bukuria e saj qëndronte në shpirt, në sjellje; ndërsa Drita qe më e shkurtër si trup, leshverdhë, me sy të kaltërt, e shkathët në lëvizje. Kjo vështronë përpëra me majën e hundës pak përpjetë. Shikonte me radhë çiftet që vallëzonin duke menduar se kush do të ishte kavaliieri i parë, që do ta ftonte të kërcente. Vera herë

ësas here vështron te me kujdes në drejtim të try-  
ezës kryesore, atje ku rrinte doktor Naimi. Kur  
kryqëzoheshin vështrimet e tyre, ajo ulte sytë si  
«turpëruar «Pse nuk vjen të më ftojë të vallë-  
zojmë?» mendonte me veten e saj. Naimi bisedonte  
dhe qështe, herë fliste me drejtorin e spitalit, herë  
më doktor Josifin, specialistin e syve. Ky ishte  
një nga imjekët, që kujdesej më pak për paraqit-  
jen e fashtme: kravatën asnijëherë nuk e kishte në  
vendin e sai, ato pak flokë, që i kishin mbetur,  
i ngriheshin përpjetë të çrregullt. E shoqja, që i  
rrinte pranë binte herë pas here me bërryl për  
ti tërhequr vëmendjen dhe për ta kujtar të rre-  
gullonte kravatën ose flokët.

ëm Agroni dhi Filipi flisnin me zë të ulët. Kujto-  
nin mbrëmjet që organizonte fakulteti i tyre dhe  
që zgjatnin gjer në mëngjez herët.

ë nesër Kërcejmë? — pyeti Agroni.

— Unë nuk njoh njeri.

ë Shko, merri Dritën. Ndërsa unë Verën...

Orkestra filloj një tango të bukur; Filipit iu  
ndes në çast një dëshirë për të kërcyer. Po kë  
të merrete nga vajzat? Të ftonte Dritën dhe me  
këtë rastrë inkërkonte ndjesë për grindjen e vogël  
në laboratori. U ngjiti Postaisanuk vuri re se drejt  
Dritës po shkonte më shpejtësi Astriti; i cili arriti  
tek qajo më përpara Dritabüpungjit. Vajza e kuptoi  
set Filipi ishte drëjtuar pëp tek qajo dhe ndjeu një  
këhaqësil të çuditshme. I verdhi këq që ai nuk arriti  
parishtës Filipi mbeti duarthatë, përpara karrigës.  
ku rrinte ajo. Dikush qeshi me të madhe nga e  
djathta. «U turpërova» vnde do doktori. «Edhe  
një herë që tilvëndosaq fës vallëzoj, nuk më vajti  
mbarë». I dukej sikur gjithë salla pësë vinte re.

Mendoi të ikte fare nga mbrëmja, të shkonte në dhomën e tij, në spital, dhe t'ja këpuste gjumit. Por nuk iku.

Agroni kërcente me Verën. Ajo nuk e kishte mendjen tek ai sepse shikonte vazhdimisht në drejtim të doktor Naimit. Salla gumëzhinte nga të qeshurat dhe të thirrurat. Tymi i duhanit qëndronte pezull mbi kokën e njerëzve si një re ngjyrë hiri e dendur. Një gjysmë ore më vonë dikush thirri niga mesi i sallës:

— Damat në fuqi.

Orkestra filloi përsëri. Në krye u ngriten dy-tri çifte pastaj filluan të shtohen. Agronin e ftoi një infermiere e repartit të tij. Filipi kish nglur sytë te gota e birrës dhe as që interesohej më se ç'bëhej në sallë.

— Shoku doktor...

Ai ngriti sytë dhe pa, për çudi, laboranten e spitalit.

— Shoku doktor, dëshëroni të kërcejmë?

— Ju falem nderit.

Filluan të vallëzojnë.

— Dukeni i mërzitur.

— Në fillim të mbrëmjes, gjendjen shpirtërore e kisha të mirë, ndërsa tani, nuk e di përsë...

Drita buzëqeshi sikur ta dinte shkakun e asaj mërzitjeje. Sa bukur që dukej kur qeshte: dy gropëza të vogla i bëheshin në qoshet e buzëve. Po më tè për i qeshnin sytë, ata sy çuditërisht të bukur!

— Tani jeni të kënaqur nga analizat e laboratorit?

Filipi e shikoi në sy.

— Ndoshta u solla ashpër atë ditë me ju. Ju kërkoj ndjesë.

— T'ju them të drejtën, në fillim u zemërova. Po pastaj më kaloi. Ju jeni i vetmi ndër mjekët që e përdorni më shumë laboratorin. I kam thënë dhe babait për këtë.

— Vërtet?

Vajza mori një pamje të trishtuar.

— Po ai nuk e vlerëson ndihmën e laboratorit. Në këtë çështje nuk jam në një mëndje me t'im atë. Filipi qeshi.

— Domethënë, paskeni hyrë në kontradikta profesionale me babanë tuaj.

— Ai e nënveftëson punën tonë.

Në atë kohë Agroni iu afrua të dyve dhe, duke vallëzuar, u pëshpëriti:

— Çifti duket i kënaqur.

Filipi nuk u përgjegj. Drita, e turpëruar, i pëshpëriti:

— Njeriu që dashurohet me të gjitha vajzat.

\* \* \*

Në dollapet prej xhami të sallës së operacionit qenë vendosur veglat e nikeluara kirurgjikale që shkëlqenin. Dy faqe muri qenë zëvendësuar me dritare të mëdha, shumë të mëdha. Instrumentistja shpërndante veglat, që do t'i duhesin kirurgut në tryezën e vogël. Narkotizonjësja përgatiste eterin, sondën dhe pincën e gjuhës.

Në një dhomë të ngushtë, ngjitur me sallën e operacionit, doktor Masari dhe Filipi lanin duart, duke i fërkuar me furcë që nga maja e gishtrinj-vet gjer te bërrylet. Filipi e shikonte shefin me bisht të syrit: «Ka tridhjetë vjet, që bën këtë punë»

mendoi me vete. Kurse ai? Ai sapo fillonte detyrën e vështirë të kirurgut. Plaku fërkonte duart dhe nuk fliste. Sytë e tij ndiqnin lëvizjen e furçës. «Këta sy i ngjasin çuditërisht syve të Dritës» mendoi përsëri Filipi.

— Gati!

Kaluan në sallë, u veshën me bluza dhe maska sterile.

— Doktor, kam frikë — pëshpëriste i sëmuri nr. 17.

— Budalla! Fëmijë je ti, që ke frikë? — i tha doktor Masari, të sëmurit, që e shikonte me sy të zgurdulluar.

Filipit i erdhi keq. I sëmuri në atë çast kish nevojë pér një fjalë të mirë, që t'i jepte zemër. Është e vërtetë se mjekimet, gjaku që po i jepnin, e ndihmonin pér së tepërmë të sëmurin, po një fjalë e mirë shpresëdhënëse nuk viente më pak se mjekimet. Po sikur t'i fliste të sëmurit? Ndoshta doktor Masari do t'ja merrte pér mungesë takti. Në fund të fundit, përse të mos i fliste? Ai nuk ishte aty hieja e shefit të tij po loste rolin e mje-kut, që duhej të ndikonte me ato që dinte, me ato që kish mësuar në spitalet e tjera.

— Mos u bëni merak! Operacioni do të vejë shumë mirë. Doktor Masari do t'ju operojë si s'ka më mirë.

I sëmuri hapi buzët e thara dhe me zë të mëkur pëshpëriti.

— Ju falem nderit.

Operacioni filloi. Doktor Masari përgatiti me mjeshtëri fushën operatore, gati pa humbje gjaku. Pincat e holla njëra pas tjetrës, shtrëngonin enët e gjakut të këputura më dysh nga thika e kirurgut.

Ja edhe cipa e hollë e barkut. Maja e thikës lëvizi në drejtim të cipës: stomaku doli në sipërfaqe, si i shtyrë nga brenda, i kuq në të verdhë, me damarë që rrahin ritmikisht. «Arteret — mendoi Filipi — që shpien gjak pa pushim».

Doktor Masari kapi stomakun me dorë dhe e kontrolloi nëpër duar.

— Ja ulçeri — tha ai.

Në sallë hyri Astriti, kryeinfermjeri, pa maskë në fytyrë dhe pa galloshe në këmbë. Në duar mbante pinca të sterilizuara, që avullonin. I vendosi mbi një çarçaf të bardhë dhe i la të zbuluar. Filipi nuk e shikonte dot këtë njeri, që shkelte rregullat e sterilitetit mu në sallë të operacionit. I vinte ta kapte për jake dhe ta nxirrte jashtë. Po doktor Masari si e lejonte të punonte në atë mënyrë? Të futej në sallë pa maskë, pa galloshe, të linte veglat e operacionit të zbuluara! Ku është disiplina e rreptë e sallës së operacionit? Të punoje në këtë mënyrë në sallë, të mos ruaje sterilitetin, do të thoshte që plagët pas operacionit të qelbzëzoheshin; që të sëmurët të mundoheshin nga ethe të forta. Dhe ndoshta shkaktari i përhapjes së mikrobeve në sallën e operacionit ishte Astriti me vakuidesinë e tij.

I sëmuri rënroi.

— Jepni vërsëri narkozë — urdhëroi doktori. Kur mbaroi operacioni, doktor Masari ishte lodhur. Ai hoqi maskën, nxori syzet dhe i fshiu.

— Punë e rëndë kjo jona — pëshpëriti plak“ duke vështruar Filipin me sytë e tij ngjyrë qielli të hapur, si të Dritës. Drita! Ç'bënte vallë në këtë kohë ajo? Ndoshta kishte kaluar nëpër pavione, kishte mbledhur material, për analiza nga të së-

murët, dhe ishte kthyer në laborator për t'i parë në mikroskop. Vajzë e çuditshme kjo Drita! Vetë e kish ftuar të vallëzonte, dhe po ajo kish filluar e para të bisedonte me të. «Dukeni i mërzitur,» i kish thënë. E c'rëndësi kishin gjithë këto gjëra? Vajzat kanë kaq teka të shumta sa duhet të jesh shumë i kujdeshëm në interpretimin e tyre. Filipi u mendua të heqë vëmendjen nga kjo vogëlsirë dhe doli nga salla për të ndjekur të sëmürin e operuar.

\* \* \*

Doktor Filipi e përdorte shumë laboratorin, ai nuk e fillonte kurrë mjekimin pa bërë analiza. Këto kërkesa të tij e vunë në telashe personelin e laboratorit, sidomos Dritën. Pati dhe ankesa, se Filipi kërkonte mjaft analiza. Dikush pëshpëriti se «doktori, me sa duket, nuk merr vesh fort nga mjekësia, ai vetëm analiza di të kërkojë».

Vetëm Drita nuk thosh gjë. Në shtëpi ajo rrinte vonë, studjonte metodat e laboratorit në mënyrë që t'i përgjigjej punës së shtuar. Ajo mendonte se Filipi vepronte drejt: laboratori klinik është ndihmës i mirë i punëtorit të mjekësisë. Dy ditë më parë Filipi kish dërguar në laborator, me anë të Astritit, disa garza dhe pinca kirurgjikale me një copë letër, ku kish shkrojtur: «T'u bëhet analizë mikrobiologjike». Më parë, Drita nuk mbante mend të ishin bërë analiza të këtilla. Astriti ja kish dorëzuar asaj këto materiale me një ndjenjë zemërimi.

— Edhe ky nuk di se ç'bën! Dërgon për ana-

lizë garza e pinca të sallës së operacionit.

— Ajo është punë e tij — ishte përgjigjur Drita.

— Që kur ka ardhur ai, punët po na venë më keq në repart. Plagët qelbëzohen. Është për t'u habitur. Ti, Drita...

— Çfarë do të thuash?

— Sepse rri e ftohtë me mua...

— Nuk kam pasur ndonjë simpati të veçantë për ty.

— Kurse unë...

— Ke më punë tjetër këtu?

— Jo, por...

— Unë kam mjaft analiza për të bërë.

Astriti u largua i mërzitur. Po, pas një ore, u kthye me garza dhe pinca të tjera në laborator duke thënë se do t'u bënte analizë bakteriologjike jo materialeve të para, po atyre të fundit. Pse vallë kish ardhur për së dyti Astriti? Dreqi e merr vesh! Në fund të fundit, ishte punë për të.

Në darkë vajza po lexonte akoma, kur u fut në dhomën e gjumit i ati. Ai iu afroa ngadalë, i vuri një dörë mbi flokët dhe ja përkëdheli.

— Akoma nuk ke fjetur?

— Po studjoj.

— Analiza?

— Gjithnjë mbi analizat.

Doktori pa orën e dorës.

— Është vonë, duhet të biesh. Nesër do të vesh në spital.

— S'kam gjumë, baba.

Masari e pa të bijën me vrejtje. Pse vallë e bija nuk kishte gjumë? Çfarë e shqetësonte zemrën e saj të re? Vajzat dinë t'i mbyllin kaq mirë të

fshehtat e zemrës së tyre, sa është zor t'i kuptosh. Masarit i dukej e çuditshme që e bija të ishte rritur dhe bërë goxha vajzë. I kujtohej ajo kur ishte e vogël, me flokë të verdhë gjithë kaçurrela, që i sulej te dera duke thirrur. Masari e merrte në krahë, e puthte dhe pastaj loste me të një copë herë. Po ja tani vajza ishte rritur, që bërë laborante dhe punonte në spital.

- Si venë analizat, Dritë? — e pyeti ai.
- Kam punë mjaft, baba.
- Vërtet?
- Doktor Filipi kërkon më tepër se gjithë mjekët e tjerë analiza për të sëmurët.
- Hm!
- Si vete ai me kirurgjinë, baba?
- Sapo ka filluar... Akoma s'mund të thuhet gjë për të. Ti tani mbylle librin dhe shko të flesh.
- Masari e mori vajzën për krahu dhe e shpuri në krevat.
- Natën e mirë, Dritë.
- Natën e mirë, baba.

Të nesërmen, Drita ishte në laborator, kur u hap dera dhe hyri brenda Filipi. U përshëndetën. Ajo sepse ndjeu rrahje zëmre.

Filipi foli i shqetësuar:

- Kam dërguar disa gjëra për analiza bakteriologjike, i kini bërë?
- Po, i kam bërë, doktor.

Vajza i dha një copë letër të shkruar, ku ishin shëhuar këto fjalë: «nuk shikohen mikrobe patogjene».

— Çudi, — pëshpëriti gati si me vete Filipi.

— Mendoja krejt ndryshe. Do të thotë se dyshimet e mia janë të kota.

— Çfarë dyshimesh, doktor?

— Si t'ju them... Jam duke studjuar një fenomen në repartin tonë të kirurgjisë. Tek ne, të sëmurëve, një pjesë është qelbëzohen plagët pas operacionit. Unë mendoj se ajo shkaktohet nga që nuk ruhen rregullat e sterilitetit. I zënë garzat me duar; futen në sallë të operacionit pa maska...

Drita e dëgjonte me vrejtje. Ajo i shikonte herë sytë, herë buzët e tij të rregullta, që lëviznin poshtë e përpjetë ndërsa ai fliste. Vajza vuri re se çdo gjë te Filipi: fytyra, trupi, lëvizja e dorës së djathtë, kur fliste, ishin në harmoni të plotë. Nuk mund të thoshte se Filipi ishte i bukur. Jo, por megjithatë, kish diçka të këndshme në fizikun e tij; madje, edhe gjakftohtësia me të cilën fliste për një problem me kaq rëndësi, siç ishte steriliteti në kirurgji; edhe kjo qetësi ja shtonte më tepër hijeshinë e tij prej burri. Ndoshta, po të ish ndonjë tjetër, si për shembull Agroni, do ish inatosur, do t'i kish rënë tryezës me grusht. Por jo, Filipi ishte tjetër njeri.

Drita nuk kishte gabuar kur kish menduar me veten e saj se Filipi ishte njeri punëtor, se ai donte të punonte në mjekësi në mënyrë shkencore. Ndërsa Agroni nuk futej thellë në punët e mjekësisë. Nuk i nxirrte vetes telashe. Ashtu ishte ai edhe në marrëdhënjet me të tjera. Sa herë që vinte në laborator dhe e gjente vetëm, i thoshte asaj se ishte vajzë e bukur, se ai e shikonte për natë në ëndërr ose e ftonte në takime në orët e vona të mbrëmjes. Një herë, i kish shtrënguar dorën fort... Këto gjëra Agroni ja përsëriste edhe

Verës, që punonte si farmaciste e spitalit. I tillë ishte Agroni. Dhe kështu dalëngadalë, Dritës i kish dalë nga zemra ky njeri që të lante e të lyente me fjalë të bukura.

\* \* \*

Agroni po ecte rrugës për në shtëpi dhe po mendohej në kish bërë mirë që i kish dërguar letër farmacistes së spitalit. Atë ditë, ç'është e vërteta, kishte punuar mjaft dhe e ndjente veten të lodhur. Duke écur, po mendohej për një çëshje që kishte rëndësi: kish vendosur të martohej. Po kë do të merrte? Rastet më të mira ishin dy: farmacistja dhe Drita ndihmëse-mjeke laborante. Nuk dinte për kë të vendoste. Farmacistja, në përgjithësi, ishte e mirë. Nuk mund t'i thoshje e bukur, por as edhe e keqe. Ajo merrte një rrogë të mirë: gati sa të tijën. Ndërsa Drita ishte e bukur, leshverdhë me mes të hollë. Asgjë nuk mund t'i shaje. Apo nuk ishte e re tetëmbëdhjetë vjeçë. Pastaj ajo që vajza e kirurgut, e një njeriu të cilët i shkentë fjala në drejtori. Vetëm se rrogën e kish më të vçgël.... Ja, rroga e prishte ca punën. Sikur ta kish më të madhe, nuk do të qe keq.

Agroni me veten e tij nuk është pranonte se ishte njeri materialist. Këto llogari, që bënte, ishin pasojë e shpirtit të tij prej njeriu praktik. S'kish si t'ja bënte: ja që ish njeri praktik. Por kjo s'do të thoshte se ishte materialist.

Herë herë i dukej se kish bërë mirë që i kish shkruar Verës. Në letër ndjenjat shpirtërore shprehën më lehtë se sa t'ja thuash tjetrit me gojë.

Letrën e kish bërë shkurt, duke vënë në dukje pse e donte Verën. Po të mos merrte përgjigje nga ajo, gjë që nuk e besonte, do t'i shkruante Dritës. Veçse Drita kohët e fundit sikur i rrinte ca si ftohtë dhe nuk i buzëqeshte më si më parë...

Një ditë, Astriti, kryeinfermjeri i repartit të kirurgjisë, i kish thënë se Drita vente shpesh në repart dhe bisedonte me Filipin. Edhe Filipi shkonte në laborator. Ç'donte të thoshte kjo?

Në shtëpi gjeti një letër. Agroni ndjeu një dridhje të lehtë. E mori zarfin, e hapi dhe e lexoi më parë emrin e atij që shkruante. E dërgonte Vera. Ja se ç'i shkruante ajo: «Letra juaj më habiti pa masë. Kam përshtypjen se ju marrëdhënjet shoqërore i kini kuptuar së prapthi. Unë ju kam konsideruar si koleg pune dhe asgjë tjetër. Në daçi të dini për zemrën time, po jua them: ajo rreh për një tjetër. Vera»

Agroni u mundua të ruajë gjakftohtësinë. Një përgjegje të tillë nuk e priste nga Vera. Po vajzat janë shejtanka. Ndoshta duhej të kish vepruar më shpejt me Verën, kurse ai e kish hequr punën zvarrë. S'ka gjë. Gjëra që ngjasin. Tani duhej kthyer nga Drita, se ndoshta mund ta ngatërronte Filipi. Ku ta dish? Këto vajza pëlqejnë më tepër kirurgun se sa patologun.

\* \* \*

Në repartin e kirurgjisë Filipi punonte me gjithë shpirt. Ai nuk shikonte as orar, as lodhje. Të sëmurët e donin dhe e nderonin, se edhe ai i donte e i nderonte. Po në repart kish edhe njerëz

që nuk e kuptonin. Nuk e kuptonte shefi i reparit, doktor Masari, nuk e donte as Astriti, kryein-fermjeri i sallës së operacionit. Si ishte e mundur që të shkonte puna mirë kur midis këtyre tre njerëzve nuk kishte asnjë mirëkuptim? Megjithëse nuk kishte shumë kohë në spital, Filipi kish arri-  
tur në këtë përfundim: gati dhjetë për qind e  
plagëvë pas operacionit qelbëzoheshin, në sallën  
e operacionit dhe në ambulancën e mjekimit nuk  
ruhej steriliteti, ditët e shtrimit në repartin e ki-  
rurgjisë kalonin normën e caktuar. Është e vërtetë  
se në hyrje të repartit qëndronte një flamur i  
kuq i vogël, ku ishin shkrojtur këto fjalë: «Repar-  
ti i dalluar», ndërsa në tabelën e nderit të spitalit  
Astritit ja kishin vënë fotografinë mu në krye.  
Në spital u qe vënë më tepër rëndësi gjérave të  
jashtme, zbukurimeve, perdeve të bardha. Siguri-  
sht, këto ishin një anë shumë e mirë, ishin të  
nevojshme për t'u krijuar të sëmurëve një ambient  
të këndshëm dhe të gëzuar, por problemi kryesor  
i repartit të kirurgjisë, steriliteti, ishte lënë pas  
dore. Pa dyshim, faji kryesor rëndonte mbi doktor  
Masarin, që nuk kontrollonte punën e vartësve të  
tij. A duhej vallë të pajtohej edhe Filipi me këtë  
gjendje? T'i mbyllte sytë dhe punët të vazhdonin  
si më parë? Kur ja kish thënë këtë mendim Agro-  
nit, ky i habitur i kish thirrur:

— Je në vete? Mendohu mirë para se të bësh  
një punë të tillë.

— Ky është një qëndrim i drejtë ndaj punës,  
ndaj të sëmurëve.

— Ke fakte?

— Fakte?! Fakte janë kartelat klinike që kam  
studjuar këtu.

— Analizat që bëre në laborator mbi garzat rezultuan sterile, pra...

— Është e vërtetë, — tha Filipi i zënë pak ngushtë. — Është për t'u habitur... Isha i bindur se ato nuk duhej të ishin sterile... Nuk e kuptoj.

Megjithatë, ai nuk do të pajtohej me këtë gjendje. Do të ngrihej në mbledhje, do të diskutonte.

Kush do ta ndihmonte nga mjekët e spitalit? Ndoshta ai do të mbetej i vetëm, pa asnje përkrahje. Në fund të fundit, le të mbetej qoftë dhe i vetëm, mjafton që ai kishte të drejtë.

Kolektivi i mjekëve qe mbledhur në orën shtatë të mëngjezit në dhomën e drejtorit të spitalit. Bëhej mbledhja e zakonshme e mëngjezit. Drejtori qëndronte në vendin e tij, i rruar, i veshur mirë, me një kravatë ngjyrë hiri, që i pëlqente më shumë se të tjerat. Ai gogësiu dhe, duke iu drejtuar mjekut të rojes, Josifit, tha:

— Filloni.

Doktor Josifi, me flokë të rëna dhe me sytë e skuqur nga pagjumësia gjatë natës së rojes, filloi të lexojë shënimet që kish shkruar në regjistër: «Gjatë ditës së djeshme dhe natën janë shtruar në spital shtatëmbëdhjetë veta. Nga këta pesë raste me dizanteri, katër me pneumoni, dy raste me apendisisis akuta, tre fëmijë me bronkopneumoni si dhe urgjencia nga aksidente automobilistike. Të sëmurët nr.12, nr.21, kanë qenë rëndë; të sëmurit nr. 60 me kancer të stomakut iu bë morfinë. Kuzhina ka qenë e pastër, ushqimi i gatuar mirë, autoambulanca ka punuar në rregull»

Drejtori u kollit dhe vështroi mjekët një përnjë. Kush e donte fjalën? Kush kish për të shtuar

ndonjë gjë? Doktor Masari vështron te një mizë në tavan. Dermatologu plak me fytyrë të këndëshme dhe të rruar freskët buzëqeshte. Drejtorit iu duk sikur doktor Filipi bëri një lëvizje. Ndoshta kish për të thënë gjë?

— Ka për të thënë njeri ndonjë fjalë?

— Unë...

«E ç'ka për të thënë ky mjek i ri?» mendoi Josifi.

«Ndoshta do të ankohet se laboratori nuk i dërgon analizat në kohën e duhur» tha me vete Agroni.

— Vetëm ju lutem sa më shkurt, me pak fjalë, ndërhyri drejtori.

— Desha të ngrija një çështje të repartit ku punoj. Në kirurgji tregohet pak kujdes...

Mjekët kthyen kokën nga Filipi. Masari hoqi sytë nga miza dhe nisi të dëgjonte me vrejtje. Filipi mori frymë thellë dhe vazhdoi më i sigurtë:

— Nga sa kam vënë re unë, gati dhjetë për qind e të operuarve pësojnë infeksion në plagë. Kjo rrjedh ngase në repartin tonë nuk respektohet steriliteti. Këtë problem ja kam ngritur shefit të repartit, por...

«E paska me doktor Masarin» mendoi drejtori.

«Ky s'është në vete sot» mendonte nga karriga e tij doktor Agroni.

«Ja një njeri parimor, që nuk ka frikë të kritikojë» thoshte me vete Naimi.

Shefi i repartit të kirurgjisë po bëhej nervoz. «Pa shiko! — mendonte. Ky mistrec kërkon të bindë kolektivin e mjekëve se punët në repartin e tij nuk venë mirë, se plagët u janë infektuar.

Dhe të gjitha këto i thotë një mjek i ri, që posa ka dalë nga bangot e fakultetit. Në vend që të shikojë, të mësojë nga ai teknikën e të operuarit, fillon të dërdëlisë marrëzira të tilla»

Ndërkojë Filipi vazhdonte të fliste:

— Sigurisht, për doktor Masarin kam nderimin më të madh. Ai njeh shumë mirë profesionin, por duhet të them se kjo nuk është mjaft. Duhet ushtruar kontroll dhe në drejtime të tjera. E tërë puna pas operacionit i është besuar krye-infermjerit të repartit...

Masari gati u ngrit nga karriga.

— Si e provon, shoku doktor, mungesën e sterilitetit?

— Prova? Fakte janë vetë të sëmurët që kanë pasur temperaturë pas operacionit dhe u janë qel-bëzuar plagët. Tani së fundi, i sémuri nr. 17, që u operua nga ulceri në stomak...

— Fakte laboratori! — thirri doktor Masari i skuqur në fytyrë dhe duke u dridhur nga inati.

— Unë e kuptoj kritikën. Të vinte të më kritikon-te një shok i vjetër në kirurgji sa dhe unë, nuk do ta merrja për fyerje, por të marr mësime nga një mjek që sapo ka filluar abecenë në kirurgji, kjo nuk hahet.

Fjalën e kërkoi doktor Naimi, sekretar i organizatës bazë.

— Shoku Filip është i ri në moshë dhe në spitalin tonë...

«Po e sulmon dhe ky Filipin» — tha me vreten e tij Agroni.

— Por shoku Masar duhet të dijë se edhe të vjetrit kanë se ç'të fitojnë nga mjekët e rinj. E reja, ndonëse në fillim me vështirësi, gjithnjë hap

rrugën përpara; të rintjtë janë si ai gjaku i ri, që do të rrjedhë ndër dejet e mjekësisë vazhdimisht, përndryshe, në mjekësi do të mos ketë gjallëri, nuk do të shkohet më tutje. Të metat që vuri në dukje shoku Filip, nuk duhet ta zemërojnë doktor Masarin, por duhet ta nxitin për të bërë një kontroll të vazhduar në personelin e repartit. C'është e vërteta, kohët e fundit në repartin e kirurgjisë raste me plagë të qelbëzuara pas operacionit ka pasur shpesh. Të themi të drejtën, kjo nuk e nderon spitalin tonë. Jam i mendimit që këtë problem duhet ta marrë në analizë drejtoria. Sa për Filipin, ky bëri mirë që e shtroi këtë çeshtje. Ne kështu na mëson partia.

Mbledhja e mëngjezit mbaroi. Mjekët dolën jashtë duke biseduar grupe-grupe. Shumica i jepnin të drejtë doktor Masarit. Me Filipin u bashkuan doktor Naimi dhe Vera, farmacistja.

\* \* \*

Kohët e fundit, Drita e ndjente veten më të lumtur. Kjo lumtëri e bënte vajzën më të shkathët në punë. Ndonjëherë shfaqej tek ajo një ndjenjë melankolie, që i zhdukej në çast kur shikonte Filipin. Kjo gjë kish filluar të ngjiste sidomos pas asaj mbrëmjes së vallëzimit kur ajo vetë kish vajtur dhe e kish ftuar të kërcenin. Ishte një ndjenjë e çuditshme, që nuk dinte si ta shpjegoente. Kur vinte Filipi në laborator për ndonjë analizë, Drita mundohej të ruante ekuilibrin e gjendjes shpirtërore. Po si ishte e mundur! Atëherë i hypte një avull i nxeh të në ftyrë. Sa turp! Ndoshta doktor Filipi e vinte re. Po ajo s'e kish në

dorë, s'e mbante dot veten. Flisnin pér mjekësinë, pér vështirësitë që ka puna mjekësore, pér punët e laboratorit. Vajzës i pëlqente më shumë ta dëgjonte Fili-pin. Kur ikte ai, atë e pushtonte ndjenja e trishtimit. Përse vallë? Asaj nuk i hiqeshin nga mendja fjalët e Filipit. «Mjekësia, Dritë, është një shkencë e gjërë; njerëzit, që kanë përqafuar këtë profesion, duhet të studjojnë vazhdimisht. Ja, merr me mend një kirurg që nuk lexon, që s'është në kontakt me të rejet e shkencës... ç'do të dalë nga ai? Asgjë. Ai do të mbetet vetëm një njeri që di të qepë lëkurë, stomak të shpuar, muskuj të këputur».

Ajo e dinte se kohët e fundit midis babait të saj dhe Filipit kishin lindur disa mosmarrëveshje. I ati bëhej nervoz më shpesh dhe pér hiç gjë. Një mbrëmje i kish thënë së bijës:

— Këta mjekët e rinj, pa dalë mirë akoma nga shpërgënjtë, vijnë e të shesin mend pér sterilitetin, qelbëzimin e plagëve, e ku di unë se çfarë. Dhe kush pa? Një djalosh, që nuk ka bërë akoma as gjashtë muaj në spital. Hm! Ngrihet në mes të mbledhjes dhe i tregon babait arat. Dhe kujt? Mua, që kam njëzet e pesë vjet në shërbimin e kirurgjisë.

Pastaj, kish shtuar me ironi:

— Kujton se di gjithë kirurgjinë po ta kesh kokën të mbushur me përkufizime dhe fjalë latine. Drita bënte sikur nuk kuptonte.

— Pér kë e ke fjalën, baba?

— Pér atë mjekun, që më kanë dërguar mua pér ta specializuar.

— Ai është i ri, baba, ka nevojë pér ndihmë, do të mësojë.

— Në është kështu, të mos shesë mend.

— Mbasse...

— Çfarë mbasse. Thotë se plagët infektohen, nuk ka sterilitet në kirurgji. Më thanë se ka dërguar në laborator tek ti disa garza për analizë, por ato kanë dalë sterile. Kështu që ai nuk ka prova.

Drita u ngrit në këmbë. Asaj menjëherë diçka iu kujtua.

— Baba, e di si është puna. Më kujtohet si tani, Gazrat m'i solli Astriti: por ai më solli dy kampionë garzash dhe më tha që të analizoja vetëm garzat e dyta. Mirëpo unë u bëra analizë të dyjave. Garzat e para dolën të infektuara me stafilokoke dhe streptokoke, ndërsa të dytata rezultuan të pastra. Unë dhashë përfundimin e garzave të dyta, ashtu siç më tha Astriti. Këtu, baba, duhet të ketë diçka të papëlqyeshme. Astriti diç do të ketë ngatërruar.

Doktor Masari shikonte vajzën me habi.

— Garzat e para dolën të infektuara?

— Po, baba.

— Pse të dytata dolën mirë?

— Nuk e di. Ato i solli Astriti pas disa orësh.

Doktor Masari mbeti një copë herë pa bërë zë. Pastaj, mblodhi grushtet dhe, duke u nisur përtë dalë, tha:

— Në këtë mes ka dallavere. — Kjo do të thotë që Filipi mund të ketë të drejtë. Ndoshë nuk u solla mirë me të. U nxitova.

Drita mbeti vetëm dhe sikur iu hoq një peshë e rëndë nga zemra.

Dy ditë më vonë, në laborator hyri Filipi. Vajza ishte vetëm, duke ngjyrosur disa analiza gjaku.

- Mirë dita!
- Analizat nuk i kam bërë, doktor, — i tha Drita.
- S'kam ardhur pér to, sot.
- Ashtu? — Drita e vështroi në sy, — Përse kini ardhur atëhere?
- Filipi u mendua.
- Përse kam ardhur? Që të të shoh ty.
- Drita nuk foli.
- Nuk do që të vij të të shoh?
- Vajza uli sytë. Ishte e turpshme dhe e ndrojtur me burrat.
- Kam një analizë me rëndësi, doktor. Doni ta shikoni dhe ju? Është një...
- Drita!
- Vajza e vështroi në sy.
- Unë dua të takohem me ty, të bisedoj...
- Filipi priti përgjegje.
- Përse nuk flet?
- Heshtje.
- Nuk vjen?
- Do të vij — tha vajza me gjysmë zëri, e turpëruar.
- Të pres në darkë, në orën shtatë, në parkun e rinisë.
- Tri ditë me radhë, mjekët qenë në telashe të mëdha. Kontrollonin kartelat, vizitonin të sëmu-rët, bënin shënime. Nga Tirana kish ardhur për kontroll një ekip mjekësh specialistë. Në reparatin e kirurgjisë kontrollonte kandidati i shkencave

mjekësore Pétrit Lamia. Filipi e kish pasur pedagog në lëndën e kirurgjisë.

- Si shkon me operacionet? — e kish pyetur ai.
- Mirë, shoku profesor, por...
- Shiko të punosh mirë, të nderosh veten, pedagogët dhe shkollën tonë të mjekësisë.
- Ka ca gjëra që nuk venë mirë...
- Për shembull?
- Nuk merrem vesh me shefin.
- Ti duhet ta dëgjosh atë.
- Grindja qëndron në disa çështje parimore, shoku profesor. Nuk mund të hesht për gjëra të tillë.

Profesori e shikon me vrejtje Filipin, si të donte t'ja lexonte mendimet.

— Ti e di ligjin e mohimit të mohimit, apo e ke harruar? Ai thotë: E reja, duke dalë nga e vjetra, nuk e asgjëson krejtësisht atë, po merr me vete anët e saj pozitive.

— Nuk e kam harruar, shoku profesor.

Në repartin e kirurgjisë, profesor Lamia konstatoi po ato vrejtje që kish bërë dhe Filipi në mbledhjen e mjekëve. Në repart kishin marrë vesh të gjithë gjestin e ulët të Astritit, i cili kish dërguar për analizë garza të sterilizuara me qëllim që të fshihte gabimet e tij. Në mbledhjen e kolektivit ai u kritikua dhe u hoq nga reparti i kirurgjisë. si njeri i papërshtatshëm në punën që bënte.

Doktor Masari tashti e kish kuptuar se nuk e kish drejtuar si duhej repartin e tij. Atë ditë e ndjeu veten të lodhur dhe të rraskapitur. Tamthat i rrini fort. Dreq o punë! Po sikur t'i hipte tensioni i gjakut dhe t'i ndodhë ndonjë hemoragji në tru? E ndjeu veten si të paralizuar, të pësh-

tetur në një bastun duke hequr këmbën dhe do-  
rën e majtë zvarrë. Iu rrënqeth gjithë trupi. Në  
pleqëri kishte mbetur vetëm me vajzën e tij, Dri-  
tën. E shoqja kishte shtatëmbëdhjetë vjet që i  
kish vdekur, që në kohën e luftës kur i kishin  
përzënë gjermanët nga qyteti. Ajo qe ftohur, kish  
marrë një pneumoni të fortë dhe kish vdekur.  
Doktor Masari e ndjeu shumë humbjen e grua së  
tij. Për disa javë qe bërë si mumje: as mendonte,  
as punonte. Me kohë, dhimbja filloi t'i pakësohej,  
dhe zuri ta merrte veten. Mori një grua në shtëpi,  
që kujdesej përritjen e Dritës së vogël.

Disa gojë të këqia thanë atëhere se doktor  
Masari jetonte si burrë e grua me atë femër.

Vitet rrodhën njeri pas tjetrit. Ai tani ishte  
plakur dhe epiqendra e jetës së tij qe përmbledhur  
në dy gjëra: te puna mjeksore dhe te Drita.

Shpesh herë, kthehej në shtëpi në orët e para  
të mëngjezit, kur gjithë qyteti flinte akoma, i lo-  
dhur sa s'thuhej nga operacionet e vështira të natës.  
I vetmi njeri, që përshëndeste në atë orë qe fshe-  
saxhiu i rrugë, i cili e ndalte punën një çast, sa  
të kalonte doktori, i uronte mirëmëngjezin, duke  
e vështruar me nderim gjersa zhdukej në portën  
e shtëpisë.

Drita ishte rritur dhe qe bërë goxha vajzë.  
Ajo qe e ëma në vend: sytë, gojën, të ecurit e  
saj. Ai e dërgoi në shkollë, ku mësoi për ndih-  
mëse mjeke.

Atë ditë, në mbrëmje, dhëmbjet e kokës dhe  
të marrurit mëndsh iu shtuan më tepër. Përnjë-  
herë, u shtri në krevat me ndjenja gjysmë të to-  
pitura. Drita, e trembur, vrapi si e marrë në spi-  
tal për të kërkuar ndihmë mjekësore.

\*\*\*

Mjekët ë trembën, se mos doktor Masari, nga ngritja e tensionit të gjakut, pësonte ndonjë hemoragi cerebrale. Po mjekimi u fillua me kohë dhe dha rezultat. Masari e ndjeu veten më mirë. Të gjithë u gjuan që ky njeri shpëtoi nga vdekja ose nga një gjyqtim i sigurt. Kolegët i shkonin me radhë, e vizitonin në shtëpi. Kujdesi, që tregonin për të shokët e punës, e preku thellë doktorin plak.

Po ai u çudit edhe më tepër kur vajza e tij, Drita, e lajmëroi një ditë se kish vajtur për vizitë Filipi. Vajza e shqiptoi emërin e tij me ndrojtje, madje me pak frikë. Ajo po e shikonte të atin në sy për të parë se ç'përgjegje do të jepte.

Doktori, pasi u mendua, tha:

— Le të vijë brenda.

Filipi hyri në dhomën e të sëmurit. Ishte i qetë dhe kish veshur një kostum të ri që kish qepur kohët e fundit.

— Gëzohem që jeni më mirë — i tha Filipi duke i shtrënguar dorën shefit të tij.

— Si venë të sëmurët në repart?

— Venë mirë, përvèç Nr. 30. Me sa duket, po dalin dyshimet tuaja. Edhe shokët e tjerë mendojnë të ketë kancer në stomak.

— Sa keq!

Të dy mjekët heshtën. Drita shikonte herë babanë e saj, herë Filipin.

— Të sëmurët pyesin për juve, doktor. Pa filluar mirë nga vizita, ata duan të dinë shëndetin tuaj.

— Vërtet? — fytyra e plakut sikur u gjallërua.

— Mos kini merak, shoku doktor. Ju qetëso-huni, shërohuni mirë. Kur kemi raste të rënda operacionesh thërrasim kirurg nga Tirana.

— Shumë mirë.

Masari po çuditej, sepse Filipi tani i dukej krejt ndryshe. U mat t'i shprehte mendimin e tij, po nuk mundi. Vetëm kur u ngrit Filipi për t'u larguar, i tha:

— Doktor Filipi, ejani përsëri. — Pastaj, u kthyesh nga e bija: — Drita, shoqëroje doktorin.

Në koridor ata qëndruan.

— Je e kënaqur që erdha në shtëpi?

— Shumë.

— Më do?

— Shumë.

— Të kujtohet kur u zemëruam për punë të analizave?

— Po.

— Dhe do të shkoja të ankohesha te drej-tori për pak.

Drita queshte e kënaqur.

— Ika, babai mund të mendojë se unë...

— Nuk e besoja që babai të më priste mirë.

— Këto ditë që ka qenë i sëmurë ka pasur kohë të mendohet mjaft. Si duket, po i shikon gjërat në një mënyrë të re.

— Ndoshta...

\*\*\*

Në Komitetin Ekzekutiv të Këshillit Popullor të qytetit hyjnë e dalin njerëz vazhdimi-sht. Çdo ditë ata kanë kaq probleme për të zgjidhur; disa

kërkojnë të takohen me kryetarin, të tjerë interesohen për strehim ose regjistrojnë fëmijët që porsa kanë lindur. Ka dhe nga ata që vijnë për të bërë formalitetet e celebimit. Përpara zyrës së gjendjes civile qëndron Filipi me Dritën të shqëruar nga Naimi, Vera dhe Agroni. Drita dukej e emocionuar, megjithëse mundohej ta mbante veten të qetë. Ajo i qe lultur babait të saj që të mos vente me ta në gjendjen civile. Vajzës i vinte zor që të shqyptonte fjalën «po» përpara të atit. Dhe ai e kish dëgjuar.

Vera e vështronte me bisht të syrit.

— Je e shqetësuar?

— Po, Verë.

— Edhe unë kështu isha kur bëra celebrimin me Naimin. Të pushton një ndjenjë e çuditshme, një gëzim i madh... shumë i madh, dhe ndoshta, pse është aq i madh, ndaj nuk e ndjen dot.

Drita do të kishte dashur që kjo ceremoni të kish marrë fund sa më shpejt, të kthehej në shtëpi dhe të rrinte vetëm me Filipin. Filipi! Sa e çuditshme është dashuria: një njeri i panjohur në fillim, me të cilin nuk të lidh asgjë, të pushton gjithë zemrën. Jeta pa të të duket e zbrazët dhe pa kuptim. Kështu e kishte pësuar edhe ajo me këtë djalosh energjik dhe pak kokëfortë. Ajo e pat kuptuar se kish filluar ta simpatizonte që në mbrëmjen e vallëzimit, që atëhere kur vajti e ftoi për të kërcyer. Ç'forcë qe ajo që e shtyti? Mos e bëri vallë vetëm për ta nxjerrë nga gjendja që kish krijuar Astriti? Pa dyshim edhe për këtë. Po më tepër e bëri se donte të vallëzonte me të, të qëndronte me këtë mjek të ri fare afër. Ai qe hutuar

në fllim. Madje e pat shkelur nja dy herë mbi këpucët e bardha dhe i kish kërkuar ndjesë, i shqetësuar. Biseduan për analizat, për kirurgjinë, për babanë e saj. Pastaj, dashuria erdhi e u rrit përditë e nga pak, nëpërmjet ndonjë vështrimi, nëpërmjet bisedave të shkurtëra në laborator. Ajo që u vuri vulën marrëdhënjeve të tyer të fshehta, që takimi në parkun e rinisë. Drita dridhej e tëra në muzgun e asaj mbrëmjeje, tek rrinin në stolin e hekurt. Vajza ndjente dorën e Filipit tek kërkonte të sajën, pastaj, shtrëngimin e të dy duarve për një copë herë të mirë. Dhe një ndjenjë e çuditshme ja pëershkoi atëhere tërë trupin nga koka në këmbë.

— Drita, të dua.

Vajza nuk i foli. Ai e afroi dalëngadalë pranë vetes dhe e puthi në faqe, pastaj në buzë. Ja, ky kish qenë takimi i tyre në parkun e rinisë. Prej asaj kohe, Drita mendonte dhe ëndërronte vetëm për Filipin.

Kush do t'i thoshte babait të saj? Drita jo se jo. Po dhe Filipi nuk kishte guxim. Këtë punë e mori përsipër doktor Naimi, i cili sapo ishte fejuar me Verën. Plaku e kish dëgjuar Naimin i qetë, pastaj i kish thënë:

— Filipi është djalë i mirë. Për këtë jam më se i bindur tani. Po unë kisha qejf që Drita të vazhdonte studimet e larta në mjekësi.

— Një gjë të tillë e dësheron edhe Filipi.

— Atëhere s'kam asnje kundërshtim.

Të dy mjekët kishin shtrënguar duart të gëzuar.

Nëpunësi i gjendjes civile i hodhi një sy çiftit të ri, gogësiu i kënaqur dhe mori me nxitim

librin e martesave, duke dashur të tregojë kështu se, pas kësaj ceremonie, kish dhe mjaft punë të tjera. Filloi të lexojë përmbajtjen e faqeve të para të librit. Këtë punë e bënte me një lehtësi të çuditshme gati mekanike. Më në fund pyeti:

— Ju, shoqja Dritë, e doni shokun Filip?

— Po.

Nëpunësi buzëqeshi.

— Ju, shoku Filip, e doni shoqen Dritë?

— Po, e dua.

1963.

## DOKTOR ARTANI

Katedra e profesorit ndodhej në katin e dytë të ndërtesës kryesore. Doktor Artan Deda, kur ishte student, kish hyrë e kish dalë nëpër ato korrider me qindra herë. Në fakultet nuk kish qënë ndonjë student i shkëlqyer. Bile profesori, në një bashkëbisedim, e kish rrëzuar duke i thënë që të paraqitej pas dy javësh. Kjo kish ngjarë aty e katter vjet më parë. Artani qe dëshpëruar atëhere, por, në fund, i zemëruar me vetveten, i qe shtruar studimit me këmbëngulje dhe e kish fituar. Që atëhere nuk e kish takuar më profesorin. Do ta mbante mend vallë ai atë ngjarje? Po dhe në e mbante mend çfarë të keqe kish këtu? Thoshin se profesori, kur kish qenë student, ish rrëzuar në provim, por ja që tani ai qe bërë pedagog dhe studentët dridheshin përpara tij.

Me këto mendime Artani qëndroi përpara zyrës së profesorit. Zemra po i rrihte fort. Duke ngjitur shkallat, pati mienduar fjalët që do t'i thoshte. Por mund të ndodhë që profesori të ishte i zënë dhe të mos e priste. Tani që ai kish arritur deri në prakun e derës nuk do të kthehej mbrapsht.

Trokiti. S'mori asnje përgjegje. Trokiti dhe një herë.

— Hyr!

Hapi derën. Në zyrë qëndronte profesori i përkulur mbi një libër, pranë tryezës së punës. Kur ngriti kokën, profesori pa një djalosh rrëth njëzet e tetë vjeç që qëndronte në mes te praku e s'bënte përpara.

— Urdhëroni — i foli sikur ta kish kuptuar ngurrimin e vizitorit. Zëri i tij qe i butë, miqësor dhe i dha zemër Artanit.

Megjithatë Artani nuk e kish ndjerë veten më keq se sa në atë çast. Fjalët, që i kish menduar për të filluar bisedën, i ngatërroi dhe i bëri lëmsh në kokë.

— Keni ndonjë punë me mua? — i tha përsëri profesori, këtë radhë pak i habitur.

— Po... Si urdhëron, shoku profesor... kisha një çështie me juve... vetjake... Ndoshta jeni i zënë?

— I zënë jam, por po ju dëgjoj. Rrini.

— Ju falem nderit.

Artani u ul, i ndrojtur, në cepin e karrigës, duke kërcitur gishterinjtë. Ai i hodhi një vështrim të shpejtë profesorit, librit, fotografisë së Pavlovit, të varur mbi mur.

«Paska filluar të thinjet». Mendoi me vete.

— Po ju dëgjoj — profesori përpëliti sytë e tij të lodhur, sikur deshi të fshihte me këtë lëvizje ndonjë perde që e pengonte të shikonte. Artani shpjegoi se ishte mjek dhe se punonte në spital. Kur ishte ndihmësmjek kish vënë re se disa fshatra e shëronin sëmundjen N. me lëngun e një bime mjaft të përhapur në ato vende. Kohët

e fundit kjo sëmundje po përhapej shumë dhe ndoshta ja viente që të studiohej, të bëheshin eksperimente mbi kafshë dhe të nxirreshin konkluzione shkencore. Artani i tregoi profesorit se ndodhte ndonjëherë që i sëmuri shtrohej në spital në gjendje të rëndë, gati i helmuar nga lëngu i bimës. Por shumë dendur të sëmurët shëroheshin pa ndihmën e mjekut. Ky mendonte se në këtë lëng duhej të ndodhej një substancë aktive që vepronte dhe zhdukte shënjet e sëmundjes. Cila ishte kjo lëndë? Si vepronte mbi organin e sëmurë apo mbi mikrobin e sëmundjes?

Ja çfarë e shqetësonë atë si mjek. Ai kish besim në mjekësinë popullore, por ajo duhej studjuar, duhej zhveshur nga bestytnitë dhe gjërat e dëmshme. Ja përse kishte vajtur atje: që të merrëj me studimin e sëmundjes N.

Të gjitha këto Artani ja tha me një frysë, herë duke u ngatërruar, herë duke bërë përsëritje. Profesori e dëgjonte me sytë gjysmë të myllur, sikur të ëndërronte. Një buzëqeshje e lehtë i përshkonte buzët e tij pak të trasha. Përse buzëqeshje vallë? Mos ishte ajo buzëqeshje shprehje e ndonjë talljeje të fshehtë? Po sikur të ish ashtu me të vërtetë? Artanin e pikoi mu në zemër. Ndoshta do të bënte mirë ta ndërpriste bisedën, t'i kërkonte ndjesë profesorit pér budallallëqet që po i fliste dhe të ikte me vrap.

Për çudi në atë kohë profesori i tha:

— Flisni, doktor. Mendimet tuaja janë interesante.

Atëherë Artani foli më hapur, më i qetë, duke sistemuar mendimet. Pushoi së fërkuari gishtërinjtë, zuri vend më mirë në karrigë dhe u pen-

dua pakëz pér shqetësimet e kota që pati në fillim.  
Pastaj e mori fjalën profesori.

— Në shkencë, i dashur, duhet durim i madh.  
Në fillim duhet të shikoni në është studiuar ky  
problem nga autorë të huaj. Kjo do të thotë se  
duhet lexuar mjaft, duhet këmbëngulje.

Profesori u ngrit duke i dhënë të kuptojë  
Artanit se i kish dhënë fund bisedimit.

## 2.

Vjollca Simos që punonte si asistente në ka-  
tedrën e profesorit, nuk i pëlqeu fare fytyra e  
Artanit. Mbi të gjitha, nuk i pëlqeu ajo ndrojtja  
e tij e madhe që e bënte të skuqeji, të pengohej  
pas karrigave, të kërciste gishtërinjtë.

«Si zor t'ja dalë mbanë punës që ka filluar.  
I duket gjë e lehtë. Prit, pas dy-tre muajsh kur  
të mos duket më këndeji. Shumë veta fillojnë kësh-  
tu si ky dhe pastaj zhduken pér gjithnjë».

Kështu mendonte mjekja e re pér Artanin.  
Vajza e kish mbaruar fakultetin e mjekësisë një  
vit më parë. Ajo kish dalë me nota shumë të mira  
dhe profesori e kish propozuar që ta mbante si  
asistente pranë katedrës. Meqenëse ishte e pre-  
gatitur mirë në teori profesori, kur mungonte vetë,  
e lejonte t'u lexonte studentëve ndonjë leksion.  
Më tepër ajo merrej me pregetitjen praktike të  
studentëve; u shpjegonte veprimin e barërave mbi  
sistemin nervor, mbi organet e kafshëve eksperi-  
mentale, që ajo i pregetistë me aq kujdes. Stu-  
dentët e shikonin këtë vajzë më admirim dhe sim-  
pati.

Kështu i shkonin ditët Vjollcës. Mbas pune, kthehej në shtëpi, lexonte literaturë mjekësore (me romane pothuaj se nuk merrej fare) dhe aty nga ora shtatëmbëdhjetë shkonte përsëri në katedër për të preqatitur lepujt ose bretkocat që i duheshin për eksperimentet mësimore. Duke punuar në këtë mënyrë, vajza e ndjente veten të kënaqur. Në kinema shkonte rrallë. Filmet nuk dinte t'i komenton dhe pas një dite harronte pothuaj dhe përbajtjen. Kur qe studente në vitin e katërt, kujtoi se ra në dashuri me një mjek që sapo kish mbaruar. Por djaloshi filloi ta mërzisë që ditët e para. Vjollcës iu neverit dhe nuk i vajti më në takim. Ajo prirej më tepër në një dashuri të heshtur ose, siç i pëlqente ta quante, për një dashuri platonike. I tillë qe tipi i saj. Më vonë ajo u dashurua pas punës me studentët dhe harroi se në gjoks fshihte zemrën e një vajze të re.

Në laborator vinin, veç studentëve, dhe mjekë që kishin filluar punime shkencore. Midis këtyre ishte dhe Artan Doda. Ai vinte me çantën e tij të fryrë nga librat, gjithnjë i ndrojtur, duke u përplasur pas ndonjë karrige dhe duke kërkuar ndjesë për zhurmën që shkaktonte. Lexonte me orë të tëra, këshillohej me profesorin dhe pastaj vonë mblidhje librat për të ikur.

— Natën e mirë, doktoreshë — e përshëndeste.  
— Natën e mirë, — ajo nuk i thoshte kurrë doktor.

Një mbrëmje djaloshi i tha Vjollcës:  
— Më falni, profesori më ka rekomanduar të lexoj librin e Boeckerit. Ndoshta ndodhet në bibliotekën e katedrës.  
— Ne nuk e kemi.

— Sa keq! Ku mund ta gjej, ju lutem?

Vjollca u mendua. Këtë libër ajo e kishte në shtëpi, në bibliotekën e saj. Ju tek njëherë, ashtu kot, pér kapriçio, mos t'ja jepte, por shpejt ndërroi mendjen.

— Librin e kam unë. Do t'jua sjell nesër.

— Ju falem nderit, doktoreshë. Mirupafshim. Të nesërmen ja solli.

«Interesant» — mendoi ajo. — «Të gjithë zgjedhin tema të bujshme, ndërsa Artani është kapur pas mjekësisë popullore».

Që atë ditë Vjollca e ndryshoi qëndrimin ndaj Artanit. Ndodhte ndonjëherë që ai të mos vinte në katedër pér tri-katër ditë: atëhere vajza shqetësohej (megjithëse nuk e bënte veten). Kur kthehej, ajo e pyeste menjëherë:

— Përse s'keni ardhur këto ditë, doktor Artani?

— Tani gjithmonë e thërriste doktor. Pastaj shtonte menjëherë si pér të humbur gjurmat. — Nuk është mirë t'i ndërprisni studimet:

— Për arësyen punë, doktoreshë. Deri diku më pengon shefi i repartit.

— Doktor Emini?

— E njihni?

— Po, e njoh... diçka?

### 3

C'është e vërteta, Vjollca e njihte doktor Emini, shefin e repartit, ku punonte Artani. Ai ish një burrë rreth nja dyzet vjeç (të paktën kaq trëgonte), me një trup të bëshëm, mjaft i kursyer në fjalë. Njerëzit në pavionin e tij rrallë herë e shikonin të qeshte. Vjollca e kish njojur në shtë-

pinë e xhaxhait të saj; që atëhere Eminin e përshëndeste kudo që ta takonte. Doktori disa herë e kish ndaluar në rrugë; e pyeste për shëndetin e saj dhe, kur largohej, nuk harronte t'i shtrëngonte dorën. Vjollca e kuptonte dhe i rrihte zemra fort. Përse vallë? Ndoshfa i vinte mirë që dikush e ndalte dhe e pyeste për shëndetin? Por sa të ftohtë dhe të shplarë ishin sytë e doktor Eminit! Ajo vetëm skuqej dhe ikte duke nxituar hapin. Për një kohë të gjatë ndjente shtërngimin e dorës së Eminit dhe vështrimin e tij. Vajza nuk i përgjigjej dot, ajo nuk mundej, nuk ndjente asgjë për të. Dhe puna kish mbetur zvarrë...

Emin Sulua nuk i humbiste shpresat. Ndoshfa një ditë çdo gjë do të rregullohej. Kish qejf që dasmën ta bënte në vjeshtë, ndërsa muajin e mjaltit ta kalonte në Pogradec. Do të donte të shkëputej për disa kohë nga pavioni i tij gjithë mikrobe, nga ankesat e të sëmurve, nga fytyrat e njerëzve që punonin në atë repart; mbi të gjitha, donte të shkëputej nga fytyra e Artanit. Po. Sidosmos nga ai.

«Kush drequin ja shtiu ndër mend të punojë në katedrën ku ishte Vjollca. Çfarë budallai! Merret me punë shkencore!» pat menduar.

Nji ditë ai takoi në rrugë Vjollcën. E ndali. I shtrëngoi dorën, ndërsa vajza bëhej ngjyra-ngjyra në fytyrë.

— Ka disa ditë që nuk ju kam parë. Mos kenë qenë sëmurë?

Vjollca buzëqeshi:

— Jo... Jam shumë mirë me shëndet. Punë kam pasur mjaft. Punoj dhe mbasdite.

— Lodheni shumë?

— Po të punosh dhe lodhesh.

Emini tundi kokën në shenjë miratimi:

— Ashtu është. Edhe unë kam shumë punë. Kohët e fundit na janë shtuar rastet me sëmundjen N. dhe na janë hapur telashe.

— Oh! meqë më kujtuat sëmundjen N. — tha Vjollca menjëherë — tek ne punon doktor Artan Doda mbi këtë problem.

Eminit nuk i erdhi mirë.

— Është një vartësi im. Me sa kuptoj unë, ai e vret kohën kot atje tek ju.

Vjollca u habit.

— Artani vret kohën kot? Përkundrazi profesori ynë është mjaf entuziast për studimet që po bën. Studimi ka interes shkencor dhe ekonomik.

— Qënkërka interesant? — Shtoi Emini pa fshehur një farë ironie por që Vjollca nuk e kuptoi.

— Po, me të vërtetë është interesant. Sikur të dalin supozimet e Artanit, ai do të japë një kontribut të mirë në mjekësinë shqipëtare. Pastaj preparati do të pregeteje në vend dhe kjo ka leverdi.

Doktor Emini nuk mund të duronte të flitej këshfu për vartësin e tij; ai e njihte mirë atë dhe e dinte sa i viente lëkura. Artani ishte një mjek i zakonshëm, me një zgjuarsi që nuk shkëlgente. Në duhej t'i vije në dukje ndonjë cilësi, kjo ishte këmbëngulja dhe kokëfortësia e tij. Ndoshta vetëm me këto dy cilësi do të hapte Artani rrugën në shkencën e mjekësisë? Kjo ishte me të vërtetë për të qeshur. Ndoshta Vjollca fliste ashtu për arësyse simpatie. Dreqi e merrte vesh! Emini e vështroi vajzën drejt e në sy. U mundua të lexonte tek ajo kuptimin e atyre fjalëve, ndjenjat që fshihnin ato. Por Vjollca uli sytë duke mos e duruar atë vësh-

trim të ftohtë që depërtonte thellë në shpirt  
— Vjollca... — i tha Eminit me një zë të  
butë si me lutje.

— Urdhëroni.

— Sonte shfaqet opera «Mrika». Unë kam dy  
bileta. Po të doni, ejani të vemi bashkë. Do t'ju  
pres përpara teatrit të operas.

Vajza u zu ngushtë. Ajo nuk e priste këtë.  
Doktor Emini e ftonte në opera. Po sikur të vente?  
Ai e donte, kuptohej. Atë mbrëmje ajo do të  
shkonte në laborator të ndihmone Artanin. Pu-  
nimet e tij po merrnin një kthesë me të vërtetë  
interesante. Artani, me ndihmën e kimistëve, e  
kish kthyer lëngun e bimës shëronjëse në një  
pluhur kristalin të imët. Ata së shpejti do të je-  
pnin edhe formulën kimike. Pastaj ai do të fillon-  
te eksperimentimin mbi kafshët e sëmura. Jo, nuk  
do të shkonte në opera. Atë e priste Artani në  
laborator. Ajo, me intuitën prej femre, e kish ku-  
ptuar se kur ndodhej në laborator bashkë me  
Artanin, ky punonte më me qejf, e gjallërohej.

— Ju falem nderit shumë, por unë sonte kam  
punë.

— Mos ma refuzoni këtë ftesë. E dini, unë...

— Me gjithë mend jam e zënë.

— Atëhere, një herë tjetër. Kur të doni ju.

— Një herë tjetër? Nuk di si t'ju them. Gati  
gjithmonë pasditeve jam e zënë.

#### 4.

Doktor Artanit i ndodhte shpeshherë të qënd-  
dronte përpara shishes, ku kish futur pluhurin  
e bardhë, me orë të tëra. Misteri qëndronte gjith-

një i fshehur në brendësinë e kokrrizave të atij pluhuri. A do ta shkëpuste vallë që andej të fshten dhe ta vinte në shërbim të njerëzve? Ajo do të ishte edhe përgjigjja më e mirë që mund t'i jepet shefit të tij. Po Vjollca ç'do të mendonte? E vërteta është se në fillim e kish pritur shumë ftohtë. Pak nga pak, si të thuash, ajo ishte zbutur, e i qe afruar. Njëherë i soll një libër që i duhej. Më vonë e ndihmonte nxjerrjen e lëngut e në kthimin e tij në pluhur. Tani që njiheshin më mirë Artani zbulonte dita-ditës te doktoresha cilësira të mrekullueshme: ishte e sjellshme, zotéronte shumë mirë fiziologjinë e njeriut dhe në përgjithësi njihet problemet teorike të mjekësisë. Mos vallë ish dashruar pas saj? Nuk dinte si t'i përgjigjej vërvetes. Sa herë që i hipnin në kokë mendime të këtilla mundohej t'i largonte. Ai s'kish vajtur në katedrën e profesorit për të bërë dashuri, por për të studjuar një problem të shkencës mjekësore. Ndoshta supozimet e tij mund të mos dilnin, e megjithatë, ai kishte besim se mjekësia popullore ishte një misionerë e pashfrytëzuar për mjekësinë moderne. Pikërisht kështu i kish thënë profesori.

— Punimet tuaja, doktor Artani, kanë hyrë në një fazë të re. Çfarë duhet të bëni tani? Me këtë pluhur — i tregoi shishen — duhen prebatitur ampula me doza të ndryshme. Njëkohësht do të provokoni te lepujt sëmundjen N. duke i infektuar me mikrobet e marra nga të sëmurët. Kur të shfaqet sëmundja, do të filloni të injektoni ampulat, d.m.th. do filloni të shëroni kafshët e sëmura. Pastaj do shohim.

— Po ampulat kush do t'i pregatisë?

— Kimistët do t'ju ndihmojnë përsëri. Unë do

të bisedoj në telefon me ta. Kjo është në interes të shkencës sonë.

— Ju falem nderit, shoku profesor — Artani fliste me zor, i mallëngjyer.

— S'është nevojë të më falenderoni. Laboratori s'është imi, por i gjithë atyre që duan të punojnë.

Jashtë ajri ishte i freskët. Natyrë vjeshte. Shpesh herë vjeshta të ngjall trishtim. Gjethet e pemëve shtriheshin për tokë me nuanca të panumurta ngjyrash: të verdha; kafe, të kuqërremta. Artani mbushi mushkëritë me ajrin e freskët të mbrëmjes dhe u nis për në shtëpi. Ishte i lodhur. Porsa të shkonte në shtëpi, do të shtrihej në shtrat megjithëse e dinte që gjumi nuk do ta kapte menjëherë. Njëmijë mendime e mbysnin në një kohë kokën e tij të lodhur nga puna e spitalit dhe nga ajo që bënte në laborator.

Lepujt i kish gjetur. Kimistët kishin marrë përsipër të pregatisnin ampulat. Si do shkonte eksperimenti? Do të dështonte vallë? Vetëm natën vonë e zinte gjumi...

Një muaj më vonë Artani tërhoqi ampulat e pregititura. Nuk i mbetej gjë tjetër veçse të fillonte nga puna: të infektonte lepujt e laboratorit me mikrobin e sëmundjes. U dha atyre të hanin ushqime të infektuara dhe priti, ditë, javë muaj. Por kafshët nuk sëmureshin, ato vetëm dobësoheshin e pastaj ngordhnin. Artani e përsëriti edhe një herë eksperimentin. Kontrollonte kafshët cdo ditë, mbante shënimë mbi gjendjen e tyre shëndetësore, mbi ndryshimet që pësonin në peshë. Lepujt e infektuar nuk sëmureshin, ata vetëm ngordhnin një e nga një. Çfarë ngjiste? Përse nuk së-

mureshin ashtu siç ngjet te njerëzit? Mos kish bë-rë ndonjë gabim? Qindra pyetje ja sulmonin trurin. Ushqimi nuk i hahej, flinte i shqetësuar dhe shikonte në èndërr fytyrat e të sëmurëve tek bisedonin për sëmundjen ashtu siç e kuptionin ata, shikonte profesorin që i buzëqeshte vazhdimisht dhe doktor Eminin, shefin e repartit. Në èndërr Artani i kërcenohej me gisht dhe e paralajmëronte se nuk do t'i drejtohej kurrë atij edhe sikur ta dinte që suksesi i punës shkencore të varej nga ai. Në djall të shkonin të gjitha: pluhuri kristalin, kafshët e laboratorit dhe koha që kish humbur.

Edhe Vjollcës i vinte keq për Arthanin. Së bashku infektonin kafshët, së bashku i kontrollonin çdo ditë dhe po bashkë i shikonin tek ngordhnin.

Një mbrëmje Artani i tha:

— C'm'u desh mua që i hyra kësaj valleje të vështirë?

— Pse flet kështu, Artan?

— Më vjen t'i marr këto ampula dhe t'i flak tutje, t'i bëj copë-copë.

— Shkenca do durim.

— Kam tetë muaj që pres, ditë e natë. Vetëm pres. Do të los mendsh. Kur të mairrin vesh dështimin tim të gjithë do të qeshin sidomos njëri.

— Cili?

— Emini!

Vjollca buzëqeshi.

— Ti je lodhur. Sistemi nervor...

— Po më flet si të jem pacient?

— Jo, Artan. Unë... desha të them... duhet të kesh kujdes për shëndetin tënd.

— Kjo punë më ka dërmuar, Vjollca.

— Lëre punën tani. Eja të dalim jashtë. Ajri-

i freskët do të të bëjë mirë. Këtu pranë ka një lulishte të bukur.

5.

Doktor Emin Sula e kish thërritur Artanin në zyrën e repartit të tij.

— Me ju është mirë të flas pa doreza — filloi Emini duke pozuar në rolin e shefit. — Këtë e bëj si shok dhe si shefi juaj. Merreni si të doni.

Ndërsa shefi i tij fliste, Artani e vështronte me kujdes. Asnjëherë s'e kish parë me aq vëmendje. Emini rrinte rëndë-rëndë në karrigë, thithte cigaren me një elegancë të studjuar ndoshta përpara pasqyrës. Ai ishte rruar atë mëngjez dhe lëkura e faqeve i shkëlqente nga kreimi. Flokët i kish të krehur me kujdes dhe herë pas here kallonte dorën e djathtë mbi ta si për t'i rregulluar akoma më mirë. Artani vriste mendjen se kujt i ngjante ky njeri. Një herë iu duk si fytyra e dikurshme e mësuesit të klasës së pestë fillore, por më vonë sikur nuk i shembelleu.

Emini fliste me zërin e tij pak të ngjirur:

— Ju merreni me disa kërkime që ju i quani shkencore...

— Dhe do të vazhdoj të merrem. Kjo më duket se është një punë e mirë që ju, si shef...

Emini i preu fjalën

— Duhej t'ju inkurajoja.

— Unë kështu mendoj. Nga ana tjetër nuk kini as të drejtë që të më pengoni. Me punë shkençore mërrem jashtë orarit, duke sakrifikuar kinematë, teatrot dhe, shpesh, orët e gjumit. Ndoshta keni ndonjë ankesë lidhur me punën?

— Ju nuk përqëndroheni në punë si më parë. Pastaj njerëzit u shikojnë natën nëpër lulishte. Sigurisht, — doktori qeshi duke nxjerrë jashtë dy dhëmbë floriri që shndrisnin — këto janë çështjet tuaja personale, por unë e kam fjalën pér ato që thonë bota, pér autoritetin tuaj si mjeq. Beso se më kuptioni.

— Të them të drejtën nuk po ju kuptoj fare.

— Ju bëni sikur nuk më kuptioni.

— Më falni shoku doktor Emini, ju me të vërtetë po flisni pa takt. Përsa i përket çështjes së shëtitjes natën kjo është pér të qeshur. Ajo femër është doktoreshë Vjollca, bashkëpunëtorja ime dhe së shpejti do të bëhet e fejuara ime.

— Ju do të fejoheni?

— Shumë shpejt, bile.

Dhoma ra në heshtje. Emini ndezi edhe një cigare. Këtë lajm ai nuk e priste. Të gjitha mendimet iu frenuan në kokë. Dëshira pér të biseduar më gjatë iu pre. Fytyra i mori një pamje tjetër, faqet sikur iu fishkën pér çudi. Artani, vartësi i tij, po i prishte ëndërrën më të bukur të jetës.

Një gjysmë ore më vonë, Artani mori autobuzin dhe u nis pér në bibliotekë pér të kërkuar një libër të rekomanduar nga profesori. Në atë libër ai do të mësonte mënyrat e ndryshme pér të infektuar kafshët e laboratorit. Në autobus harroi çdo gjë: bisedën me doktor Eminin dhe ironinë që fshihej prapa atyre fjalëve. I harroi të gjitha sikur të mos kishte ngjarë asgjë. Kështu ishte ai. Ndërsa maqina ecte, mendonte vetëm Vjollcën dhe ampulat e mbushura me lëngun shëronjës.

Eksperimentet i treguan Artanit se kafshët nuk sëmureshin si njerëzit. Atëhere si do t'i bëhej halli? Artani e studjoj vëllimin e rekomanduar nga profesori brenda tri javëve. Lexonte natën deri vonë dhe një orë në mëngjez para se të shkonte në punë. Nga studimi nxori këto konkluzione: që të infektoheshin kafshët e të sëmureshin, u duhej ulur në minimum rezistenca e organizmit. Kjo arrihet duke u dhënë të hanin ushqime të varfëra në vitamina sidomos në vitaminë C.

Filloi eksperimentet nga e para. Mori një grup lepujsh dhe i la për disa kohë nën veprimin e rrezeve ultraviolete. Në të njëjtën kohë i ushqeu për një muaj rresht me ushqime të varfëra në vitamina. Në fund të muajit infektoi lepujt me mikrobet e sëmundjes të marra nga të sëmurët e spitalit. Pastaj priti një javë, dhjetë ditë. Lepujt sikur t'ja bënин për inat. Nuk sëmureshin. Artani shqetësohej, pinte shumë cigare, dobësohej. Edhe Vjollcës nuk i vinte mirë.

— Artan, nuk bën kështu. Ki kujdes se do të infektohesh vetë nga mikrobet e do të sëmuresh.

Ditën e dytëdhjetë dëshpërimi kish arritur kulmin. Qe lodhur e rraskapitur. Por më shumë e mundonte ideja e dështimit. Hyri në laborator, iu afroa lepujve i zemëruar (sikur t'ja kishin ata fajin) e po i shikonte, ashtu siç bënte përherë.

— Jo, s'është e mundur! — thirri menjëherë — Ndoshëta më bëjnë sytë — dhe dolli me vrapi duke bërtitur:

— Vjollca! Vjollca!

E mori përdore dhe e shpuri pranë lepujve.

— Artan... lepujt kanë shenjat e sëmundjes.

Nuk i sheh?

— I shoh... Po nuk më besohet.

— Artan i dashur, më në fund ja arrite që-

llimit. Lepujt u sëmurën.

Fitorja ish arritur, më në fund.

— Vjollca, eja të të puth.

— Këtu?

— Ke turp nga lepujt?

Të nesërmen doktori Artani filloj mjekimin e lepujve të sëmurë. Çdo ditë, u fuste në venë nga një miligram lëng. Këtë punë e bëri një javë rresht. I peshonte, u merrte gjak për analiza, i kontrollonte. Ditën e pestë mbas mbarimit të mje-  
kimit, doktori vuri re, i emocionuar, se te lepujt shenjat e sëmundjes qenë zhdukur. Sytë iu njo-  
mën me lot. Qenë lot gëzimi dhe mallëngjimi të përziera bashkë.

Konferanca e gjerë mjekësore do të zhvillo-  
hej pas dy muajsh. Në konferencë do të refero-  
nin profesorë, docentë, kandidatë të shkencave mje-  
kësore dhe mjekë. Mbi kërkimet e tij do të refe-  
ronte dhe mjeku Artan Doda. Artanit nuk i beso-  
hej se kishte përfunduar një punë shkencore me  
rëndësi. Dy vjet më parë sikur t'i thosh njeri se ai  
do të merrej me kërkime, do të ish gajasur së qe-  
shuri. Po ja që për çudi papritur e pakujtuar, një  
krimb i çuditshëm filloj ta brejë, në fillim nga-  
dalë pastaj më shumë e më shumë. Profesori i kish  
thënë se nëpërmjet asaj konferencë ai do të bënte  
të njojur përfundimet e punës së vet.

— Të flas përpëra profesorëve? T'ju them të  
drejtën, më mungon guximi.

— Doktor Artani, ju tani nuk jeni më student.

Ja filloi punës. Lexonte, shkruante, prishte, shkruante përsëri. Ditët kalonin javët gjithash tu. Sa më shumë afrohej data e konferencës aq më shumë ai shqetësohej. I dukej se do të jepte dhe një herë një provim të rëndë jo përpara një profesori, por përpara gjithë profesorave. Referatin e mbaroi së shkruari dy javë më parë dhe ja dorëzoi profesorit. Dy ditë më vonë, kur mori dosjen, mbeti me gojë të hapur nga habia: profesori i kish mbushur fletët me vija të kuqe, me shënime «të zgjerohet», «të flitet më shumë për veprimin farmakodinamik të preparatit».

Në fillim doktor Artani u inatos. Por menjëherë u pendua dhe e vrau ndërgjegja që mendoi keq për profesorin.

«Ai e bën për të mirën e punës, kurse unë budallai...»

Ditën që do të hapej konferenca, Artani nxitonte në drejtim të ndërtesës, ku do të zhvilloheshin punimet. Salla ishte mbushur plot e përplot. Një pjesë të mirë ai i njihte se i kish pasur pedagogë. Midis tyre dalloi fytyrën e profesorit dhe zemra iu ngroh. Në një vend tjetër qëndronte doktor Pali, plaku simpatik, mjeku më i vjetër i spitalit, pranë të cilit ai punonte. Ja edhe pranë tij doktor Emini i rruar freskët me një kostum blu, me jakën e këmishës të ngirirë me kollë, tek rrinte rëndë-rëndë. Po Vjollca ku ishte? Ajo i kish premtuar se do t'i ruante një vend. Më në fund e gjeti.

— Vjollca mirë mëngjezi!

— Artan, nuk të njoha fare.

Konferenca filloi punimet. Profesorët refero-

nin një nga një mbi tema të ndryshme mjekësore.

Mbasdreken e ditës së dytë kryetari i presidiut mitit ftoi Artanin në mikrofon.

Të gjithë dëgjonin me kujdes këtë mjek të ri të veshur me kostum ngjyrë hiri, që fliste për një bimë me veti shëronjëse, për mikrobin e së-mundjes N., për lepujt e infektuar, për mjekimin që u kish bërë. Tema ishte origjinale dhe me interes praktik. Kush mund të thoshte se një ditë të mos përdorej ky sukses eksperimental dhe te njerëzit? Ndoshta tani ishte shpejt akoma të mendje për një gjë të këtillë, por një ditë ajo mund të bëhej realitet. Så shembuj të këtillë mund të numëronte njeriu në mjekësi!

Në sallë doktor Pali s'e mbante dot gëzimin.

— Ju kam thënë — i thosh Eminit — se Ar-tani do të lërë gjurma në mjekësinë tonë.

— E pse, ç'ka bërë? S'është ndonjë shpikje kush e di se çfarë.

— Ju po e bëni si ata njerëzit me vezën e Kristofor Kolombit!

1965

## OPERACIONI

Autoambulanca frenoi me forcë përpara derës së hekurt të spitalit. Zëri i burisë prishi qetësinë e natës dhe zgjoi nga dremitja portierin plak. Me përtesë ai hodhi një vështrim nga dritarja e vogël, por sytë iu vranë menjëherë nga drita e fortë e maqinës. U ngrit duke mërmëritur diçka nëpër dhëmbë.

— Kush je ti? — pyeti me zë të ngjirur.

— Jam unë, o xha Dullë, shoferi i spitalit.

— Ah! Ti qenke!...

Shoferi nxori kokën nga dritarja e maqinës dhe pyeti:

— Xha Dullë, kush është mjek roje?

— Kirurgu.

— Cili nga të dy? Plaku apo i riu?

Xha Dulla nuk u përgjegj. Iu afrua portës prej hekuri të lyer me bojë vaji si në të kuq, një bojë e shëmtuar, ngriti llozin përpjetë dhe dera e rëndë u hap duke rënkuar.

— Plaku apo i riu, more xha Dullë? Të paska zënë gjumi sonte — e shpoi shoferi.

— Plaku, ore, plaku. Doktor Hasani...

Shoferi shtypi gazin. Maqina lëvizi nga vendi, kapërceu portën dhe qëndroi përpara derës së spitalit. Infermierja e rojes doli te dera.

— Ç'na ke sjellë, mor Rrapo?

— Një urgjencë.

— Urgjencë? Tani kaq vonë?

— Urgjencat nuk të pyesin as ty, as mua. Kështu më thanë, kështu po të them. Unë s'jam doktor.

— Qenke me inat sonte ti, Rrapo. Ke pirë ndonjë gotë?...

— Ti shiko punën, shoqe. Merr të sëmurin, ajo është puna jote. Dy sanitare morën të sëmuran me barelë. Ish një burrë rrëth nja dyzet e pesë vjeç, i zbehtë, me ballin të mbuluar me djersë. Fytyra e tij shprehte shqetësim dhe frikë. Herë pas here i vinte për të vjellë. Një grua e re, shumë e shqetësuar, i rrinte pranë.

— Mos u bëj merak — i jepte zemër ajo të shoqit. — Patëm fat që gjetëm doktor Hasanin. Ai të ka operuar nga stomaku; ai ta njeh sëmundjen ty... Do të bëhesh mirë.

Dera e ambulancës u hap dhe brenda u fut një burrë i hijshëm, i mbajtur mirë, rrëth të gjashëdhjetave. Gruaja e re u ngrit në këmbë, iu afrua me ndrojtje.

— Mirë mbrëma, shoku doktor... Im shoq është shumë sëmure. Është keq si atëhere kur e operuat ju...

Doktori nuk u përgjegj. Iu afrua të sëmurit, i mori pulsin. Nën gishtërinjtë e tij ai ndjeu një puls të shpejtë e të dobët. Gjuha i qe tharë dhe i dhimbte barku.

— Të dhëmb? — Doktori fliste pak, ngadalë, por zëri i tij të ngjallte nderim.

— Më dhëmb.

Doktor Hasani u ul dhe shkroi në kartelën: «Stomak i operuar. Shtrohet në observacion».

E ndjente veten të lodhur, sytë i rëndonin. Do të donte të shtrihej në krevat, të mbyllte sytë dhe të flinte. Po ja që të sëmurët nuk e lejnë rehat. Dikush ka dhimbje në stomak, nji tjetrit i dhemb zemra. I sëmuri Nr. 37 e kish pasur temperaturën 40 gradë. Pastaj operacionet: të planifikuara dhe të pa planifikuara. Dita e rojes ish plot telashe, e lodhshme sa nuk thuhej. Dhe këtë punë e bënte prej kaq vjetësh. Sa herë roje kish bërë? Sa njerëz kish operuar? E kush i mbante mend!?

Ndonjë edhe i kish vdekur, por ai, si kirurg, i kish bërë të gjitha përpjekjet.

Mbas çlirimt u ndërtua një spital i ri; përmjekët u krijuan kushte pune shumë të mira: laboratori, sallë operacioni me të gjitha pajisjet moderne dhe kuadro. Cdo vit shtoheshin mjekë të rinj. Edhe atij i kishin dërguar një mjek, pothuaj djalosh, për ta bërë kirurg. Tani e kishte më lehtë. Doktori i ri qe i zgjuar dhe shumë shpejt po e përvetësonte teknikën e të operuarit. Aq më mirë dhe për të dhe për doktor Hasanin. Nga këto mendime e shkëputi infermierja e rojes.

— Shoku doktor, i sëmuri u shtrua.

— Erdhe, Sofi? Filloni mjekimin. Vetëm... Çfarë desha të thosha?... Ah po, vetëm belladon mos i jepni.

— Si urdhëron.

Doktor Hasanit iu hap goja. Infermierja i hodhi një sy doktorit plak dhe sepse i erdhi keq.

— Pse nuk flini, doktor? Eshtë vonë? Po shkxon tre!

\* \* \*

Doktor Astriti, i veshur me bluzë të bardhë e të pastër, hyri në sallën Nr. 3. Përshëndeti të sëmurët dhe filloj nga vizita. Pyetjet ishin po ato: temperaturë, dhimbje, të vjella, kontrolli i plagës së operuar. Ish një procedurë e mërzitshme, monotonë, por e domosdoshme, nga e cila nuk shpëtoje dot. Pastaj duheshin dëgjuar me durim ankesat e të sëmurëve, që nuk kishin të mbaruar Ankesat pér dhimbje, pér pagjumësi, pér ndonjë infermieri të pandërgjegjshme. Të gjithëve u duhej dhënë përgjegje, me takt, pér të mos lënduar gjendjen e tyre shpirtërore.

I sëmuri Nr 35 dukej i shqetësuar.

— Po puna ime si do të vejë, shoku doktor?

— Puna jote si do të vejë? Shumë mirë, i dashur, mos u mërzit. Të mbajmë më tepër pse duam që të fuqizohesh pér ta përballuar më mirë operacionin. Bisedova me doktor Hasanin dhe vendosëm që nga java të të operojmë.

— Falem nderit.

Përpara krevatit të të sëmurit me stomak, doktor Astriti u ndal më gjatë. Duhej studjuar inë mirë; duhej pyetur më gjatë. I sëmuri përgjigjej me plogështi të madhe. Pastaj kish diçka, një shprehje të atillë të çuditshme, që vetëm një mijek i vëmendshëm mund ta kapë: diçka që të thotë se i sëmuri nuk vete mirë, duhet mbajtur në vrejtje. Ajo hundë e holluar, ai rrëth ngjyrë mavi që po

krijohej nën gropat e syve, një djersë e hollë mbi ballë, një farë shqetësimi, të gjitha këto të marra së bashku flisnin për diçka të keqe, për një proces infekzioni të lokalizuar diku në organizmin e të sëmurit. E vizitoi me kujdes. Barku nuk i pëlqeu. Sapo prekte vendin e stomakut, i sëmuri hidhej përpjetë. Doktor Astriti mendoj me vete:

«Do të jetë shpuar ulçeri. Janë shënjat e para të peritonitit. Duhet operuar sa më shpejt.»

Mjeku doli nga salla. Infermierja e ndoqi pas.

— Nuk më pëlqen ky bark. Duhet hapur. Salla e operacionit të bëhet gati! Të preqatiten instrumentet për stomak!

Duhesh lajmëruar shefi i kirurgjisë, doktor Hasani. Po sikur të gabonte? Mos vallë po nxitohej? Po sikur të priste edhe disa orë? Shefi i tij ishte i lodhur nga roja, por megjithatë duhej thirrur, duhej bërë konsultë.

— Doktor Hasani është pa gjumë nga roja...

— tha Sofia.

— E di. — Astriti ndezi një cigare.

— E lajmëroni me anën e shoferit të autombulancës në mund ta operojë vetë. Në mos po të... vijë...

Astriti e dinte shumë mirë se «plaku» nuk do të lejonte që ta operonte ai vetë. Ishte i sigurt se ai do të vinte në sallën e operacionit sado që ishte pa gjumë e i lodhur. Doktor Hasani ishte shef i repartit të kirurgjisë. Asgjë nuk mund të bëhej pa u pyetur ai. Këtë e kish të kjartë Astriti. Ai ishte një kirurg i zoti, kish fituar një respekt të madh midis njerëzve. Kush nuk e njihte doktor Hasanin?

Doktor Astriti kish vënë re se kohët e fundit shefi i tij paraqitej i lodhur, ngandonjëherë, duke operuar, sikur i dridheshin edhe gishtërinjtë. Ai e dinte se po t'i dridheshin duart një kirurgu, ishte njësoj si të braktisje profesionin e operatorit. Por plaku nuk e bënte veten. Në operacion, duke makuar nervozitetin, i thosh atij:

— Doktor Astrit, mos t'ju vijë rëndë. Puna e asistentit është një gjë e madhe në kirurgji. Ai duhet t'ja kapë mendimin kirurgut pa ja thënë ky. Nuk mund të bëhet kushdo asistent kirurg. Ju lutem ngrejeni pak stomakun pse nuk e shoh ulçerin.

Astriti bindej. Në operacionin e stomakut plaku përdorte një metodë të vjetër që ishte braktisur nga shumë kirurgë: qepte vetëm brimën e shpuar të ulçerit. Kurse tani hiqeshin dy të tretat e stomakut të sëmurë nga ulçeri. Për këtë Astriti kish hapur një diskutim me doktor Hasanin, por ky ngulte këmbë se metoda që përdorte i kish dhënë përfundime shumë të mira. Ai ja kish thënë këtë me një ton të prerë.

Doktor Astriti shoqti cigaren. Dera u hap. Ai dëgjoi zërin e Sofisë:

Doktor Hasani erdhi. Ju pret në sallën e operacionit.

Plaku po fërkonte duart me sapun e me vurcë, kur doktor Astriti u fut brenda. Ai nuk e ngriti kokën për ta parë. Vetëm pyeti:

— I bëtë morfinë të sëmurit?

— Si urdhëron:

— Lahuni doktor Astrit.

- Po tensionin e gjakut si e ka i sëmuri?  
— Të ulët!  
— Ka nevojë për gjak?  
— I kemi filluar transfuzionin doktor.

Anestezia u bë në rregull. Plaku mori thikën në dorë, fiksoi lëkurën dhe tërhoqi një vijë. Në fillim diçka e bardhë u duk, pastaj kjo vijë u mbulua me gjak. Doktor Hasani e ndjente vete të lodhur. Ku u gjet tani ky operacion! Po sikur t'i fillonin t'i dridheshin duart? Ç'do mendonin të tjerët? Ndoshta do të thoshin se doktor Hasani po fillonte të plakej. Ju kujtua koha kur pat ardhur për herën e parë si kirurg në atë spital. Ishte i ri atëhere. Operonte dhe nuk ndjente lodhje. «Ç'është rinia! Gjallëri, jetë. Si Astriti.» Por prej asaj dite kishin kaluar shumë vjet. Ai tani ishte një plak me flokë të thinjur, por, mbi të gjitha, i lodhur dhe pa gjumë. Megjithatë ai operonte: ja stomaku i të sëmurit, ja tek rrini arteret e vogla, ja dhe ulçeri në stomak. Këtë ulçer ai e kish qepur dhe njëherë tjetër disa vjet më parë. Por tani ishte shpuar përsëri. Mos vallë kish të drejtë Astriti kur thoshte se kjo metodë ishte vjetëruar dhe nuk i shpëtonte të sëmurët nga aksidente të mëvonshme? Përse ai nuk ishte interesuar për ta përvetësuar atë metodë të re operimi? Mos ishin këto shenjat e një konservatorizmi në punën e tij? Ndofta Astriti kishte të drejtë. Një valë e ngrohtë, si avull i nxehjtë, ja mbuloi tërë trupin. Për një çast iu duk se të gjitha forcat e organizmit po e linin. Po sikur të rrëzohej? Ja dhe duart nuk i bënин më. Po i dridheshin. Sa keq! Dhe sytë nuk po i shikonin mirë. Ku ishte ulçeri? Edhe arteret i dukeshin sikur nuk po pulsonin më.

— Doktor, çfarë kini? Nuk e ndjeni veten mirë? — pyeti Astriti i shqetësuar.

Plaku mblodhi veten.

— Nuk dij se çfarë kam. Nuk e ndjej veten mirë. Ejani këtu në vendin tim dhe vazhdoni ju. Unë po ju asistoj.

Doktor Hasani e shikoi Astritin në sy.

— Kaloni në vendin tim — e urdhëroi përsëri.

Astriti u bind. Mori thikën e operacionit dhe zgjeroi edhe më plagën. Gishtërinjtë e tij lëviznin shpejt dhe me saktësi. Plaku e shikonte dhe habitej me këtë shkathësi. Sa bukur që e zinte pincën! Sa mirë që pritte me gërshërë! Sa bukur që preu stomakun, pa humbur shumë gjak. Ndërsa ai, doktor Hasani, nuk kish pasur besim tek ai djalosh!

«U plaka,» mendoi përsëri me veten e tij. «Ndoshta duhet të dal në pension.»

Ai, doktor Hasani, në pension! Një dhimbje ja pushtoi tërë shpirtin. Si është e mundur? Me gjithë mend duhej të paraqitej te drejtori i spitalit dhe t'i thosh se ai mendonte të tërhiqej në pension? Ndoshta do të ishte më mirë të merrte lejën e zakonshme dhe të çlodhej në një kamp pushimi. Po, ashtu do të bënte. Do kërkonte lejën vjetore.

Operacioni mbaroi me sukses. Të dy kirurgët filluan të zhvishen më ngadalë. Astriti theu heshjen i pari.

— Doktor, si e ndjeni veten tanë?

— Jam më mirë. Më kaloi. Ju falem nderit.

Astriti ndezi një cigare dhe po shikonte nga dritarja. Ndjeu mbi sup një dorë të lehtë. Ishte

dora e doktor Hasanit. Ç'po ndodhëtë vallë në shpirtin e doktorit plak?

— Astrit — tha doktor Hasani. — Kam ndër mend të marr lejën. Jam ca i lodhur dhe dua të pushoj. Nuk e ndjej veten mirë. Ti do të mbetesh vetëm në repartin e kirurgjisë. Unë jam i kënaqur nga puna jote dhe kam besim se do t'ja dalësh në krye.

Të dy kirurgët shtrënguan duart. Doktor Hasani, pak i kërrusur, me hapa të ngadalta, doli nga reparti i kirurgjisë. Në shpirt e njente veten më të qetë dhe më të lehtësuar.

## EMIRA

Emira po bënte një vit që punonte në spitalin tonë. Dhe nuk punonte keq. Kur erdhi në fillim, qe ca e mërzitur, e drojtur. Kuptohet që s'kishte besim në forcat e veta. Unë isha i qartë për këtë. E cili mjek fillon të punojë që ditët e para i sığurtë në diagozat që jep, në recetat që lëshon? Edhe unë kalova nëpër rrugë. Prandaj dhe e mbajta pranë. E këshilloja e, ngandonjëherë, e kritikoja me takt për të mos e lënduar.

Shefe e repartit qe doktoresha Pandora, mjekë e vjetër dhe me eksperience, që e njihet mirë zanatin e vet. Atë ditë u vendos të hapej në qytetin tonë një konsultore për fémijë. Duhej dërguar një mjekë në atë sektor të ri. U vendos që të shkonte Emira. Dërgova një infermiere për ta thirrur dhe, si drejtor i spitalit, t'i komunikojë vendimin.

Sikurse thashë, në fillim qe e drojtur, rrallë fliste në mbledhjet e mjekëve dhe e merrte fjalën vetëm kur kërkonte ndihmën e ndonjë specialisti. Kur kaloja për kontroll nga reparti i fémijëve, e gjeja me stetoskopin në vesh duke vizituar të

sëmurët e vegjël. Ata, duke qarë, i zinin me duart e tyre të vogla tubin prej gome të stetoskopit dhe ja hiqnin nga veshët. Ajo s'mërzitez. Rregullonte aparatin, u dëgjonte frymëmarrjen, u prekte bar-kun, u hapte gojën, u lëvizte kokën. Mësoi mirë t'u shtinte të sëmurëve gjak në kokë nga venat e qafës, t'u merrte lëng nga palca e kurrizit. Do-emos, në fillim i dridhej dora dhe balli i mbushej me bulëza djerse, por që atënere kish kauuar mjaft kohë. Ajo tanë e cte me këmbët e saj. Pikë-riشت në këtë kohë duhej t'i thoshja se do të pu-nonte në një vend tjetër, në konsultoren e fëmi-jëve.

Emira, dy muaj më parë, qe fejuar me një inxhinier që punonte në një ndërmarrje të qyte-tit tonë. E uruam që të gjithë. Na thanë se kish marrë një djalë të mirë. Më njoju me të në një mbrëmje vallëzimi që organizuam me rastin e 1 Majit. Emira dhe i fejuari rrinin bashkë, njeri pranë tjetrit. Ai fliste më tepër, ndërsa Emira e dëgjonte. Ç'i thoshte vallë? I shikoja e, sakqa, m'u kujtua dhe mua koha e fejesës me time sho-qe. Ashtu qëndronim dhe ne pranë njeri-tjetrit e unë flisja më tepër. E çfarë s'i thoshja. Qesha ca me vete.

— Ndërsa po mendoja, dëgjova të trokiturat në derë.

— Hyrë — thashë.

Te praku u duk Emira, me bluzën e bardhë. Mbi xhepin e sipërm lexova Dr. e. N. të qendisur me ngjyrë qielli të çelur.

— E dini përsë ju kam thirrur?

— Jo.

— Uluni!

Emira u ul për karshi meje. Ajo po më shikonte me habi. Ndoshtha thosh me vete «ç'të ketë ngjarë»? Mos kisha diktuar ndonjë të metë në repartin e saj dhe tani e thërrisja për ta kritikuar?

— Emira, — fillova — ju kam thirrur t'ju njoftoj një urdhër të seksionit.

Vajza po më dëgjonte me vëmendje. Shikoja sytë e saj të këndshëm nga nisej një vështrim që më depërtonte tejpërtej. Buzët i kishin mbetur gjysmë të hapura dhe shprehnin habi.

— Puna qëndron kështu, — vazhdova unë — tek ne do të hapet konsultorja e fëmijëve. Seksioni ka vendosur që atje të punoni ju. Rëndësinë e këtij institucioni të ri, si pediatre, e dini më mirë se unë. Të hënën do të filloni nga puna atje...

— Unë mjeke konsultoreje! — tha ajo e habitur.

— Po.

— Si është e mundur! Sa fillova ta ndjej veten të sigurt në punë, ju më propozoni, si pa të keq, që të vete në konsultore.

— Këtu s'ka asgjë të keqe!

— Si s'paska asgjë të keqe!

Emira po merrte flakë. Shikoja se si vala e zemërimit po e pushtonte dalëngadalë atë vajzë me trup të imët. Ashtu e nevrikosur, ajo dukej më e bukur, me sytë të shkëlqyer nga zemërimi. Më erdhi keq. E pashë të arësyeshme t'i shpjegoj missionin humanitar të mjekut të konsultores. Asaj do t'i takonte t'u mësonte nënave të reja se si t'i ushqenin fëmijët, si t'i vishnin, që të rriten të shëndetshëm dhe kështu të kishim më pak të sëmurë në spital.

Emira nuk më dëgjonte më. Ajo i kish mbu-

shur sytë me lot. E shikoja që vajzës i vinte keq të ikte nga spitali, nga kolektivi ynë, me të cilin ishte mësuar për një vit rresht. Dhe ja, tani unë, papritmas, po i thoshja se do ta transferonim në një vend tjetër. Megjithëse puna në spital qe më e rëndë, ajo nuk donte të ikte...

... M'u kujtua se si, një mbrëmje, tek bënte Emira roje, vajta në spital për të parë gjendjen e të sëmurëve. Më është bërë zakon. S'ka ditë të mos vete në mbrëmje në spital, ku qëndroj ndonjë orë e ndonjëherë më tepër. Kur nuk shkoj, e marr mjekun e rojes në telefon që nga poliklinika dhe e pyes si i ka punët. Por atë mbrëmje vajta vetë me autoambulancë. Infermierja e rojes më tha se Emira kishte vajtur te i sëmuri nr. 35, në dhomën e veçantë. Zakonisht, në atë dhomë vendosnim të sëmurët më rëndë, që kanë nevojë më tepër për qetësi. Në atë kohë ndodhej i shtruar në atë dhomë një poet i ri, emri i të cilit nuk më kujtohet, që vuante nga leucemia. Deri tani, ndaj kësaj sëmundje në mjekët jemi të çarmatosur. Kuptohet se ai qe mjaft i sëmurë. Ne nuk kishim lënë gjë pa bërë për ta shpëtuar, por, për fat të keq, nuk patëm asnjë rezultat. U drejtova për atje, por nuk u futa në dhomë. E kisha vështirë të ndeshesha me vështrimin e zgjuar të atij djaloshi, që qe bërë kockë e lëkurë. Duke pritur Emirën për të dalë që andej, dëgjova këtë bisedë:

- Pse nuk flini? Gjumi ju bën mirë.
- Po shkruaj, që ta ndjej më pak dhimbjen.
- Kështu lodheni më shumë...

— Duke punuar harroj veten. Kam në dorë një poemë, ku flitet për një njeri, që, megjithëse i mbërrthyer në shtrat, mendon të bëjë diçka që t'i

shërbejë shoqërisë. — Dua ta mbaroj sa më shpejt, se s'dihet...

— Mos mendoni ashtu. Po bëjmë gjithshka që të bëheni më mirë. Ju e kini parë...

— Ju falem nderit. Po kur lexoj vështrimet tuaja të shqetësuara, kuuptoj gjithshka.

Emira doli nga i sëmuri i pikëlluar. Edhe mua më vinte keq. U pamë sy në sy dhe nuk folëm. Fjalët ishin të tepërtat atë çast. Ne mjekët ndeshemi shpesh me gjëra të këtilla. Disa mendojnë se nuk prekemi fare nga skena të kësaj natyre. S'është e vërtetë. Më bënte përshtypje vullneti i fortë, optimizmi që kishte në vetëvete ky djalë i ri. Atë ngjarje ja tregova dhe sime shoqëje në shtëpi. Për pak sa nuk i shkuani lot...

E përshkrova këtë ndodhi për të treguar se Emira kishte një shpirt delikat. Punia në spital e kishte thithur dhe ajo e dashuronte atë, ndaj nuk dëgjonte të ikte në konsultore. — Por shefi i seksionit më merrte gjithmonë në telefon dhe më tërhiqte vëmendjen pse ajo nuk po paraqitej në detyrën e re. — Fola gjatë me të. I kujtova shokët dhe shoqet e saj, që kishin shkuar në fshat për të ndihmuar njerëzit të ruajnë shëndetin. Nuk i mbushej mendja.

— S'kam aq pregatitje, — ngulte këmbë ajo.

— Unë apo fillova të jem e sigurt...

— Po kë të dërgojmë sipas teje? Doktoreshën Pandora që është e kaluar nga mosha dhe që së shpeiti do të dalë në pension?

Emira ngrinte supet belbëzonte.

— Unë...

Të nesërmen në mëngjez, në mbledhjen e mjevê, erdhi vetë shefi. Kur mjeku i rojes mbaroi

së raportuari mbi gjendjen e spitalit, ja dhashë fjalën shefit. Ai u koll, i hodhi një vështrim të shpejtë Emirës dhe filloi të flasë me ngadalë si të donte të sistemonte mendimet.

— Erdha në mbledhjen tuaj sot jo pa qëllim. Mendova të shqyrtojmë së bashku një problem që na intereson të gjithëve. Ju kini dëgjuar se në qytetin tonë do të hapet për herë të parë një konsultore përfémijë. Kjo është një gjë shumë e mirë. Në këtë konsultore është caktuar të punojë një mjeke e spitalit tuaj, Emira. Por ajo s'pranon, nuk do të shkojë. Për këtë punë kam ardhur në mbledhjen tuaj, që të shqyrtojmë së bashku qëndrimin e saj.

Për një farë kohe, pllakosi heshtja. Mjekët i drejtuani sytë nga Emira. Kjo e ndjeu veten ngushtë. U skuq dhe uli kokën.

Jashtë koha qe e vrërët. Disa pika shiu vinnin e përplaseshin nga era në xhamet e dritarës. Pikat e ujit rrëshqisnin poshtë duke përshkruar mbi qelq një rrugë dredha-dredha, si lotët mbi faqe.

I pari e kërkoi fjalën doktor Fatosi. Ky është kirurgu i spitalit tonë, burrë me flokë që kanë filluar të thinjen prej kohësh në tamthat. Zanatin e tij, c'është e vërteta, e njeh mirë. Punojmë së bashku prej disa vjetësh dhe është shtylla kurrizore e spitalit. Njerëzit e duan dhe kanë besim tek ai kur operohen. Kjo është një gjë e madhe përfnjë kirurg. Për kirurgët thonë se dhjetë vjetët e para u dridhen duart nga pasiguria, dhjetëvjeçarin e dytë operojnë mirë dhe dhjetëvjeçarin e tretë duart fillojnë t'u dridhen përsëri, por këtë radhë nga pleqëria. Sidoqoftë,

Fatosi është një mjek që nă nderon. Ai, pra, kërroi fjalën i pari.

— Unë, për veten time, e kam filluar punën si kirurg në një spital të vjetër dhe pa asnjë farë komoditeti. Ashtu qenë kohët atëhere. Askush nuk çante kokën. Por vështirësitë më mësuani shumë gjëra. I thirra nevojës, sic i thonë fjalës, dhe ajo erdhi. Ndryshe është tani. Emira sapo bën hapat e para në rrugën e vështirë të mjekësisë. Unë e kuptoja këtë, Emira është e re dhe s'ka pse t'u trembet vështirësive.

Kirurgu heshti, u mendua pak, pastaj tha:

— Kaq kisha për të thënë.

Pas doktor Fatosit e mori fjalën dekanja e trupës sonë, Pandora.

— Me hapjen e konsultores po realizohet një dëshira ime e vjetër, që më parë kishte mbetur vetëm një ëndërr. Më vjen mirë që atje është caktuar një mjeke pediatre, sic është Emira. Po, t'ju them të drejtën, habitem pse shoqia jonë nuk do të shkojë atje. Unë mund të them, tani, që nëqoftëse na sëmuren shumë fëmijët, kjo vjen nga që një pjesë e nënave tonë të reja nuk dinë akoma t'i ushqejnë ose t'i veshin sipas rregullave. Vetëm me këshilla mund të kem shëruar me mijëra fëmijë dhe kushedi se sa herë jam ftuar nëpër ditëlindjet e tyre. As shpërblimi më i madh nuk më ngjallte kënaqësi më të madhe se sa pritja e mirë e njerëzve... Eh, më përpara e kemi pasur më të vështirë. Kurse tani njeriu ka mundësi të mëdha për punë për të zhvilluar aftësitë e tij. Po, ngrihen spitale, dalin çdo vit me dhjetëra mjekë të rinj, të cilëve, ne, më të vjetërit, do t'u dorëzojmë stafetën. E megjithatë, na mbetet mjaft

për të bërë. Kush do t'u mësojë nënave të rritin fëmijë të shëndoshë? Pa dyshim mjekët, e, në radhë të parë, ata të konsultores. Si shoqe pune që jam me Emirën, dua t'i them që t'i hyjë këtij problemi. Atëherë do të kemi më pak të shtruar në spital. Megjithëse kam hyrë në dekadën e gjashtë të jetës sime, do të përpiqem ta ndihmoj sa herë të ketë nevojë.

I hodha një vështrim me bisht të syrit Emirës tek rrinte në vendin e saj. C'mendonte ajo në atë çast? Ndoshta e ndjente veten në hall të madh? E megjithatë ne i flisnim kështu, se e donim, se dëshëronim që ajo të kapërcente sâ më lehtë dhe në mënyrë të ndërgjegjishme këtë ngurrim. Emili, infektionisti ynë, kërkoi fjalën.

— Karrierën time e nisa në Durrës, në vitin 1938. Në vitin e parë pas çlirimt, u transferova në Rubik, ku nuk kishte as autoambulance, as farmaci. Merreni me mend! Sapo kishim dalë nga lufta të djegur e të shkatërruar. Sëmundjet bënin punën e tyre. Njerëzit gjithmonë ja kanë pasur nevojën mjekut, sepse u shëron ose u lehtëson dhimbjen. Vura të gjitha forcat ta kryeja detyrën dhe s'kish këncadësi më të madhe përmua kur shihja se ata i shpëtonin vdekjes. Dhe sa mirënjohës ianë njerëzit e thjeshtë, punëtorët. E ndjeja mirënjojen e tyre te kujdesi dhe nderimi që trigonin ndaj meje; e ndjeja kur ata thoshnin: «Hapuni, se erdhi doktori». Ky kujdes më prekte, më mallëngjente. E kuptoja që njerëzit më nderonin dhe jo rrallë herë më zgjidhnin në presidium kur minatorët bënin mbledhje. Pra, këta njerëz të thjeshtë, këta punëtorë, që një pjesë të jetës së tyre e kalonin në galeritë e nëndheshme, respek-

tonin punën time. Puna jonë ka të bëjë me një-rezit e gjallë. Për mjekun, fronti kryesor është njeriu. Këtu në spital na ndodh shpesh të grindemi midis nesh për çështje të diagnozës: është pneumoni apo pleurezi? Në këto polemika profesionale s'ka asgjë të keqe. Përkundrazi, pastaj, thërrësim një të tretë për të dhënë mendimin. Rëndësi ka që mjeku të shpëtojë njeriun, pa kudo qoftë është njësoj.

Fjalët e Emilit më pëlqyen fort. Të gjithë po e dëgjonin me vëmendje. Jashtë shiu vazhdonte të binte. Herë pas here nga qelli vinte në veshët tona gjëmimi i shurdhëri i ndonjë bubullime të largët. Emira kish mbështetur faqen në pëllëmbë dhe shikonte nga dritarja. E kisha të vështirë të kuptoja se qëndodhët në shpirtin e saj. Mbështetur tek ajo, diku thellë, bëhej luftë mendimesh: të shkonte apo të mos shkonte në konsultore? Kush do të fitonte? Arësyjeja apo mendimet që e pentagonin? Po ajo a nuk do të fliste? Nuk do të thoshte mendimin e vet? Për çudi, sikur t'ja kisha kup-tuar idenë, Emira u ngrit dhe tha:

— Unë e kam thënë dhe më parë se nuk mund të punoj në këtë sektor. Kjo punë është një barrë e madhe përmua; e ndjej se nuk do ta bëj dot. Ajo është punë me përgjegjësi. Do të jem vetëm, pa një mjek që të më udhëzojë. T'ju them të drejtën, nuk kam guxim. Ju e dini që organizmi i fëmijëve është shumë më i ngatërruar se i të rriturve, prandaj atje duhet të jetë një mjeke me eksperiencë.

Mbasi mbaroi, u ul në vendin e saj. E kisha të qartë: ajo u trembej vështirësive dhe nuk kish

besim në forcat e veta. Mua dhe shokëve të mi na takonte që t'ja ngjallnim besimin e humbur asaj vajze të re, që s'kish më shumë se një vit që e kish mbaruar shkollën.

Në këtë kohë e kërkoi fjalën doktor Ylviu, një mjek i ri, i cili është përgjegjësi i rinisë në spital. Ai me Emirën kanë mbaruar së bashku fakultetin dhe në një ditë u emëruan në spitalin tonë.

Ai tha:

— Mua nuk më pëlqen aspak diskutimi i shoses Emira — Ylviu u koll duke vënë dorën përpara gojës. Ne jemi shokë që të dy dhe njihemi mirë. Por unë dua ta kritikoj pér frikën që ndjen disa herë përpara vështirësive. Më vjen keq me gjithë mend. Ndoshta ajo do të zemërohet, por megjithatë unë do t'ja them: nuk e këshilloj Emirën që të vazhdojë karrierën e vështirë, por fisnike, të mjekut në këtë mënyrë. Le të mendojë pér një çast mjekët partizanë, që në kushte jashtëzakonisht të vështira, pa barëra, pa instrumente, mjekonin dhe shëronin partizanët e plagosur. Sa e sa sakrifica kanë bërë ata! Kurse ne sot punojmë në kushte që ata as mund t'i ëndërronin atëhere. Po e them përpara të gjithëve, në rast se drejtoria e shikon të arësyeshme megjithë që jam i një profili tjetër, mund të shkoj vetë në vendin e Emirës.

Ylviu fliste me zë të fortë, si të ishte në mbledhje me të rintjtë. Herë pas here i shoqëronte fjalët me lëvizjen e dorës së djathtë; ashtu siç bëjnë shpesh infermierët. Toni i tij m'u duk te-për i rreptë. Ajo nuk duhej gjykuar aq ashpër. Emira qe një vajzë me shpirt delikat dhe tepër e ndijshme. Ndoshta fjalët që thamë pér të mund ta

shtynin të bënte të kundërtën: t'i ngjallnin ndjenjat e një kokëfortësie të sëmurë. Prandaj, gjithë ato ditë, mbas mbledhjes, e mbaja pranë, i jepja guxim dhe mundohesha t'i rrësja besimin në veten e saj. Shëfit i thosha se duhej të prisnim ca ditë derisa ajo ta kapërcente atë çast të vështirë për të e të vendoste. Mbledhja e kolektivit asaj i kishte lënë mbresa. Bisedova me shefin e seksionit. Ne mund ta detyronim të vente atje, do të mjaftonte një shkresë, një urdhër, një veprim zyrtar. Por nuk u ngutëm. Donim që ajo të bindej, t'i mbushnim mendjen se ajo i kish të gjitha mundësitë ta kryente detyrën, se ish në gjendje t'i kapërcente vështrësitë, donim ta bindnim të kishte besim në forcat e saj dhe se ndihma nuk do t'i mungonte.

Njëherë, portieri më lajmëroi sé një inxhinier kërkonte të më takonte. Po vrisja mendjen, se cili do të ishte ai inxhinier që kishte punë me muq, «Ndoshta», thashë me vete, «ka të shtruar ndonjë njeri në spital dhe kërkon të dijë se si i ka punët». E lejova të futej në drejtori. Përparrë meje qëndronte i fejuari i Emirës, me atë trupin e gjatë dhe flokët e krehur me kujdes. I thashë të ulej. Vinte tek unë për çështjen e Emirës. Jashtjegova, megjithëse ai e dinte. Por ajo që më habit i fakti se, edhe ai ishte i mendimit që Emira të shkonte në konsultore. Për këtë që grindur me të fejuarën.

Një ditë në gazetë u botua letra e hapur. Që prej asaj dite zemrat e punonjësve sikur u ngritën peshë: një hov revolucionar i papërshtkuar i rrëmbeu që të gjithë. Në mendimet tonangjau një gjë e çuditshme dhë filluam të shkundi dembi nga ajo gjendje hamullie, ku ishim futur.

Ato ditë pashë me gjithë mend bukuritë e figurës morale të punonjësve të spitalit. Pata përshtypjen se tek ne u hapën të gjitha dritaret dhe se nëpërmjet tyre hyri nji ajër i ri, i pastër, i shëndetshëm. Njerëzit po i shikonin gjérat me një sy tjetër, po gjykonin me një ményrë të re. Edhe vetë u shkunda, u gjallërova në punë. Shpesh shokët më kritikojnë për zvarritje të problemeve për mungesë operativiteti. U gjallërova dhe unë. Njerëzit nuk po vinin re më për orar; i prisnim të sëmurët mirë. Shoferët e ambulancave punonin ditë e natë. Ndërsa qyteti fle, maqina lëviz orë e çast: sjell të sëmurë në spital, thërret kirurgun dhe infermierët e sallës së operacionit për të operuar ndonjë rast urgjent pas mesit të natës.

Ylviu iu përgjegj letrës së hapur duke kërkuar të shkonte në lokalitetin më të largët. Ne e përcollëm me dashamirësi. Kur po ndahej, na tha:

— Fshati për mua është fusha e betejës. Mjekët duhet të jenë sa më pranë njerëzve, në mes të tyre, të shkrihen bashkë me ta. Atëhere do të kemi më pak sëmundje...

Që të gjithë iu përgjegjën thirrjes. Vështroja Emirën. Po ajo a do ta kuptonte këtë kthesë të fortë? Ndoshta mendonte si një mikroborgjeze. «Unë le t'i kem punët në vijë, pa për të tjerët aqë më bën». Brënda shpirtit të saj me siguri zhvillohej luftë e rrëptë. Ndërgjegjja e saj qe venë përpara provës: Të shkonte apo jo atje ku e kërkonte interesë i përgjithshëm? Si do ta kapërcente ajo këtë kontradiktë?

Atë mëngjerez e takova në korridorin e spitalit. Dukej e lodhur dhe e rraskapitür nga shërbimi i rojes. Tërë natën nuk kish vënë gjumë në sy,

mbasi ish marrë me mjekimin e një fëmije në gjendje shumë të rëndë. Megjithatë në sytë e saj, lexohej një gëzim i papërshkruar, që e ndjejnë të gjithë mjekët kur shpëtojnë një njeri.

— Si duket fëmija — e pyeta?

— Besoj se shpëtoi. Meqë u takuam — tha — desha t'ju thosha se që nesër nuk do të vijë më në spital. Vendosa të...

Nuk e mbaroi frazën dhe as që ishte nevoja. E pashë tek largohej e qetë me duart në xhepet e bluzës për në gardërobë. Buzëqesha.

1966.

## **PASQYRA E LËNDËS**

### **TREGIME E SKICA USHTARAKE**

	fage
Duel me flakën .....	5
Komandanti i kompanisë .....	14
Dikujt i ngjet kjo hije .....	28
Posti luftarak .....	38

### **TREGIME E SKICA MJEKËSORE**

Dy kirurgët .....	51
Doktor Artani .....	87
Operacioni .....	105
Emira .....	114